


ENHANCEMENTS IN THE QUALITY OF EDUCATION
AND TRAINING IN SOUTH EASTERN EUROPE



Udhëzues për realizimin e moduleve të
praktikës profesionale për (Teknikun
Bujqësor të Kultivimit Intensiv dhe
Organik) Agrobiznes



Botues

Education Reform Initiative of South Eastern Europe - ERI SEE

Dečanska 8a, 11000 Belgrade, Serbia

www.erisee.org, office@erisee.org

Redaktor

Igor Nikolov

Autorë

Albert Kopali

Igor Nikolov

Radiša Mikarić

Dejan Milunović

Bekë Mulaj

Mustafa Pendić

Veljko Tomić

Rishikues

Tina Šarić, Sekretariati i ERI SEE

Ivana Živadinović, Sekretariati i ERI SEE

Për botuesin

Tina Šarić

Botuar

Qershor, 2024

ISBN-978-86-82886-06-8

Përmbajtja

Hyrje.....	5
1. Aspekte të përgjithshme për realizimin e procesit të mentorimit/praktikës profesionale për teknikun bujqësor të kultivimit intensiv dhe organik.....	6
1.1. Të Nxënit nëpërmjet Punës (TNP)	6
1.2. Roli, të drejtat dhe detyrimet e mësuesit përgjegjës për praktikatat profesionale dhe mentorit në biznes në procesin e të nxënit nëpërmjet punës	8
1.3. Qasja inovative ndaj procesit të të nxënit nëpërmjet punës praktike.....	9
1.4. Parime/udhëzime të përbashkëta për përgatitjen dhe zbatimin e procesit inovativ të të nxënit nëpërmjet punës.....	10
1.5. Metodatat inovative për procesin e të nxënit nëpërmjet punës (përdorimi i mekanizimit, pajisjeve dhe mjeteve përkatëse, të të nxënit ndërdisiplinor, puna individuale dhe në grup, projektet, kërkime praktike, etj.)	11
1.6. Vlerësimi përmbledhës në shkollë dhe vlerësimi i jashtëm i procesit të të nxënit nëpërmjet punës	13
1.7. Modelet e dokumentacionit të kërkuar për regjistrimin e procesit të të nxënit nëpërmjet punës dhe punës praktike	14
2. Aspekte specifike për realizimin e procesit të mentorimit/praktikës profesionale në lidhje me kultivimin e bimëve njëvjeçare	15
2.1 Kultivimi i bimëve njëvjeçare – Propozimi i praktikave profesionale për të mbështetur arritjen e rezultateve të të nxënit	15
2.2 Kultivimi i bimëve njëvjeçare – burimet e nevojshme dhe nevojat e nxënësve	16
2.3 Kultivimi i bimëve njëvjeçare - shembull i detajuar	18
2.4 Kultivimi i bimëve njëvjeçare - shembull i detajuar i materialeve të ndryshme mësimore	24
3. Aspekte specifike për realizimin e procesit të mentorimit/praktikës profesionale në lidhje me kultivimin e bimëve shumëvjeçare	26
3.1 Kultivimi i bimëve shumëvjeçare – Propozimi i programit të praktikës profesionale në biznes për të mbështetur arritjet e Rezultateve të të Nxënit	26
3.2 Kultivimi i bimëve shumëvjeçare – burimet e nevojshme dhe nevojat e nxënësve	28
3.3 Kultivimi i bimëve shumëvjeçare - shembull i detajuar.....	29
3.4 Kultivimi i bimëve shumëvjeçare - shembull i detajuar i materialeve të ndryshme mësimore	37
4. Aspekte specifike për realizimin e procesit të mentorimit/praktikës profesionale për prodhimin blegtoral.....	38
4.1 Prodhimi blegtoral – Propozimi i programit të të nxënit nëpërmjet punës për të mbështetur arritjet e Rezultateve të të Nxënit	38

4.2 Prodhimi blegtoral – burimet e nevojshme dhe nevojat e nxënësve.....	40
4.3 Prodhimi blegtoral - shembull i detajuar.....	41
4.4 Prodhimi blegtoral - shembull i detajuar i materialeve të ndryshme mësimore	49
5. Termat	51
6. Referencat	52

Hyrje

Ky Manual është hartuar për të ndihmuar mësuesit e praktikave profesionale dhe mentorët në biznes që punojnë me nxënësit të cilët synojnë marrjen e kualifikimit si Teknik Bujqësor të Kultivimit Intensiv dhe Organik. Manuali është përpiluar nga një grup pune i përbërë nga ekspertë në kuadër të projektit të titulluar “Rritja e cilësisë së arsimit dhe formimit në EJL – EQET SEE”.

Baza për përgatitjen e Manualit për mësuesit e praktikave profesionale dhe mentorët në biznes janë rezultatet e të nxënit mbi të cilat bazohet kualifikimi i teknikut bujqësor të kultivimit tradicional dhe organik, të cilat klasifikohen në grupe sipas teknologjive të përdorura në fushën e kultivimit bujqësor.

Manuali synon të ofrojë udhëzime në lidhje me organizimin e trajnimit praktik të nxënësve. Udhëzimet e paraqitura në këtë Manual synojnë lehtësimin e punës së mësuesve të praktikave profesionale dhe të mentorëve në biznes për të bërë të mundur lidhjen e njohurive të fituara gjatë trajtimit të lëndëve teorike profesionale me punën për përfitim të aftësive të nevojshme praktike.

Materiali në këtë Manual është i ndarë në katër seksione:

1. Aspekte të përgjithshme për realizimin e procesit të mentorimit/praktikës profesionale për Teknikun Bujqësor të Prodhimit Intensiv dhe Organik.
2. Aspekte specifike për realizimin e procesit të mentorimit/praktikës profesionale në lidhje me kultivimin e bimëve njëvjeçare.
3. Aspekte specifike për realizimin e procesit të mentorimit/praktikës profesionale në lidhje me kultivimin e bimëve shumëvjeçare.
4. Aspekte specifike për realizimin e procesit të mentorimit/praktikës profesionale në lidhje me prodhimin blegtoral.

Seksioni i parë i Manualit shpjegon procesin e të nxënit nëpërmjet punës dhe rolin e mësuesit të praktikës profesionale dhe të mentorit në biznes në lidhje me këtë proces. Në këtë seksion jepen udhëzime për zbatimin e qasjeve, parimeve dhe metodave inovative gjatë realizimit të trajnimit praktik të nxënësve, si dhe burimet digjitale që mund të përdoren në këtë aspekt. Kjo pjesë trajton edhe aspektet që kanë të bëjnë me vlerësimin dhe dokumentimin e procesit të praktikave profesionale.

Tre seksionet e mëposhtme përmbajnë udhëzime në lidhje me planifikimin dhe zbatimin e trajnimit praktik të nxënësve sa i takon teknologjive të kultivimit tradicional dhe organik. Ato janë përpiluar së bashku, si një e tërë, duke adresuar parimet mbi të cilat mund të bazohet procesi dhe burimet e nevojshme. Planifikimi i procesit specifikon metodat, mënyrën e punës, monitorimin dhe vlerësimin e ecurisë së nxënësve në punën për përvetësimin e aftësive të nevojshme. Udhëzimet i referohen procesit të trajnimit praktik i cili duhet të kryhet me pjesëmarrjen aktive të nxënësve me qëllim përvetësimin e aftësive të nevojshme. Kjo qasje garanton vendosjen e lidhjes ndërmjet njohurive të fituara nga nxënësit dhe aftësive praktike, si dhe plotësimin e punës për përvetësimin e kompetencave të nevojshme nga ana e nxënësve. Në fund të këtij procesi, nxënësit do të jenë të gatshëm t'i përdorin aftësitë e fituara në punën e tyre të ardhshme. Shpresojmë që ky Manual të shërbejë si udhërrëfyes për mësuesit e praktikave profesionale dhe mentorët në biznes për kualifikimin e Teknikut Bujqësor të Kultivimit Intensiv dhe Organik, si dhe të shërbejë si një shtysë për zbatimin e parimeve dhe metodave bashkëkohore në punën për përgatitjen dhe zbatimin e proceseve inovative për trajnimin praktik të nxënësve.

1. Aspekte të përgjithshme për realizimin e procesit të mentorimit/praktikës profesionale për teknikun bujqësor të kultivimit intensiv dhe organik

1.1. Të Nxënit nëpërmjet Punës (TNP)

Ky Manual është hartuar për të ndihmuar mësuesit e praktikave profesionale dhe mentorët në biznes që punojnë me nxënësit të cilët synojnë marrjen e kualifikimit si Teknik Bujqësor të Kultivimit Intensiv dhe Organik. Manuali është përpiluar nga një grup pune i përbërë nga ekspertë në kuadër të projektit të titulluar “Rritja e cilësisë së arsimit dhe formimit në EJK – EQET SEE”.

Baza për përgatitjen e Manualit për mësuesit e praktikave profesionale dhe mentorët në biznes janë rezultatet e të nxënit mbi të cilat bazohet kualifikimi i teknikut bujqësor të kultivimit tradicional dhe organik, të cilat klasifikohen në grupe sipas teknologjive të përdorura në fushën e kultivimit bujqësor.

Manuali synon të ofrojë udhëzime në lidhje me organizimin e trajnimit praktik të nxënësve. Udhëzimet e paraqitura në këtë Manual synojnë lehtësimin e punës së mësuesve të praktikave profesionale dhe të mentorëve në biznes për të bërë të mundur lidhjen e njohurive të fituara gjatë trajtimit të lëndëve teorike profesionale me punën për përfitim të aftësive të nevojshme praktike.

Materiali në këtë Manual është i ndarë në katër seksione:

1. Aspekte të përgjithshme për realizimin e procesit të mentorimit/praktikës profesionale për Teknikun Bujqësor të Prodhimit Intensiv dhe Organik.
2. Aspekte specifike për realizimin e mentorimit/praktikës profesionale në lidhje me kultivimin e bimëve njëvjeçare.
3. Aspekte specifike për realizimin e mentorimit/praktikës profesionale në lidhje me kultivimin e bimëve shumëvjeçare.
4. Aspekte specifike për realizimin e mentorimit/praktikës profesionale në lidhje me prodhimin blegtoral.

Seksioni i parë i Manualit shpjegon procesin e të nxënit nëpërmjet punës dhe rolin e mësuesit të praktikës profesionale dhe të mentorit në biznes në lidhje me këtë proces. Në këtë seksion jepen udhëzime për zbatimin e qasjeve, parimeve dhe metodave inovative gjatë realizimit të trajnimit praktik të nxënësve, si dhe burimet digjitale që mund të përdoren në këtë aspekt. Kjo pjesë trajton edhe aspektet që kanë të bëjnë me vlerësimin dhe dokumentimin e procesit të praktikave profesionale.



Tre seksionet e mëposhtme përmbajnë udhëzime në lidhje me planifikimin dhe zbatimin e trajnimit praktik të nxënësve sa i takon teknologjive të kultivimit tradicional dhe organik. Ato janë përpiluar së bashku, si një e tërë, duke adresuar parimet mbi të cilat mund të bazohet procesi dhe burimet e nevojshme. Planifikimi i procesit specifikon metodat, mënyrën e punës, monitorimin dhe vlerësimin e ecurisë së nxënësve në punën për përvetësimin e aftësive të nevojshme. Udhëzimet i referohen procesit të trajnimit praktik i cili duhet të kryhet me pjesëmarrjen aktive të nxënësve me qëllim përvetësimin e aftësive të nevojshme. Kjo qasje garanton vendosjen e lidhjes ndërmjet njohurive të fituara nga nxënësit dhe aftësive praktike, si dhe plotësimin e punës për përvetësimin e kompetencave të nevojshme nga ana e nxënësve. Në fund të këtij procesi, nxënësit do të jenë të gatshëm t'i përdorin aftësitë e fituara në punën e tyre të ardhshme.

Shpresojmë që ky Manual të shërbejë si udhërrëfyes për mësuesit e praktikave profesionale dhe mentorët në biznes për kualifikimin e Teknikut Bujqësor të Kultivimit Tradicional dhe Organik, si dhe të shërbejë si një shtysë për zbatimin e parimeve dhe metodave bashkëkohore në punën për përgatitjen dhe zbatimin e proceseve inovative për trajnimin praktik të nxënësve.

1.2. Roli, të drejtat dhe detyrimet e mësuesit përgjegjës për praktikat profesionale dhe mentorit në biznes në procesin e të nxënësve nëpërmjet punës

Të gjitha subjektet e përfshira në procesin e të nxënësve nëpërmjet punës kanë rol dhe përgjegjësi të caktuara. Ky seksion do të trajtojë rolin përkatës, të drejtat dhe detyrimet e mësuesit përgjegjës për praktikat profesionale dhe mentorit në biznes, si dhe format e kërkuara, të cilat janë vendimtare për zbatimin e suksesshëm të procesit të të nxënësve nëpërmjet punës (TNP).

Roli, të drejtat dhe detyrimet e mentorit në biznes	Roli, të drejtat dhe detyrimet e mësuesit të praktikave profesionale
<p>Ndjek trajnimin për kualifikimin si mentor dhe merr certifikatën e mentorit.</p> <p>Merr pjesë në përgatitjen e programit për zbatimin e praktikave profesionale në biznes, në bashkëpunim me një mësues të shkollës profesionale.</p> <p>Përgatit dhe përcakton punët dhe detyrat për nxënësit, përfshirë edhe nxënësit me aftësi të kufizuara, në përputhje me kurrikulën dhe programin e praktikës profesionale.</p> <p>Prezanton strukturën organizative dhe veprimtarinë e një biznesi para nxënësve.</p> <p>Prezanton para nxënësve rregullat dhe masat për shëndetin dhe sigurinë në punë.</p> <p>I cakton nxënësit në vende pune dhe informon mbikëqyrësin në lidhje me praninë e nxënësve në atë vend pune.</p> <p>Njofton punonjësit për praninë e nxënësve.</p> <p>Monitoron pajtueshmërinë me rregulloret dhe masat e shëndetit dhe sigurisë në punë.</p> <p>Mentoron, monitoron, vlerëson dhe mban evidenca në lidhje me ecurinë e nxënësve.</p> <p>Komunikon me mësuesin në lidhje me punën dhe përparimin e nxënësve.</p> <p>Merr pjesë në takime me mësuesin, koordinatorin dhe prindin.</p> <p>Kontrollon dhe mban dokumentacionin në lidhje me zbatimin e praktikës profesionale të nxënësve.</p> <p>Merr pjesë në procesin e zhvillimit të provimit përfundimtar.</p> <p>Informon shkollën dhe organet përgjegjëse të biznesit për të gjitha çështjet e rëndësishme që lidhen me praktikën profesionale të nxënësve.</p>	<p>Ofron mbështetje pedagogjike dhe metodike për mentorin në biznes.</p> <p>Monitoron zbatimin e programit të praktikës profesionale.</p> <p>Shpreh nevojën për ngritjen dhe zhvillimin profesional në biznes.</p> <p>Përgatit nxënësit përpara angazhimit të tyre nga një punëdhënës në biznes.</p> <p>Verifikon gatishmërinë për të mësuar rreth shëndetit dhe sigurisë në punë.</p> <p>Kontrollon nxënësit brenda biznesit gjatë zbatimit të programit të praktikës profesionale.</p> <p>Përgatit listën e vendeve të mundshme të punës për nxënësit gjatë realizimit të praktikës profesionale në bashkëpunim me personat përgjegjës nga biznesi.</p> <p>Harton planin dhe programin vjetor për zbatimin dhe monitorimin e praktikave profesionale të nxënësve.</p> <p>Harton së bashku me mentorin e biznesit planin dhe programin vjetor operativ për zbatimin e praktikës profesionale bazuar në kurrikulën përkatëse.</p> <p>Merr pjesë në realizimin e provimit përfundimtar.</p> <p>Zhvillon dhe përdor instrumente për të monitoruar, vlerësuar dhe regjistruar praktikën profesionale/të nxënësve nëpërmjet punës.</p> <p>Monitoron ecurinë e nxënësve në procesin e praktikës profesionale/ TNP-së.</p> <p>Bën vlerësimin e përbashkët me mentorin e biznesit.</p> <p>Mban rregullisht dokumentacionin pedagogjik.</p>

1.3. Qasja inovative ndaj procesit të të nxënit nëpërmjet punës praktike

Udhëzimi për procesin e të nxënit nëpërmjet punës për mësuesit e praktikës profesionale për kualifikimin e "Teknikut bujqësor për kultivimin intensiv dhe organik" parashikon përshtatjen e qasjeve inovative për zhvillimin e praktikave profesionale. Kjo do të thotë që nxënësit do të kenë përvojë reale dhe do të përfshihen në mënyrë aktive si në punë mësimore ashtu edhe në punë praktike. Të nxënit nëpërmjet punës është një formë e Arsimit dhe Formimit Profesional dual që çon në një kualifikim profesional dhe organizohet në bashkëpunim midis ndërmarrjeve dhe institucioneve të arsimit dhe formimit profesional. Qëllimi i këtij modaliteti mësimor është krijimi i mundësive për nxënësit e institucioneve të Arsimit dhe Formimit Profesional për të përdorur njohuritë e tyre në mjediset e punës përmes bashkëpunimit me ndërmarrjet nga sektori publik dhe privat dhe, në të njëjtën kohë, për të gjeneruar përfitime për ndërmarrjet në sektorët përkatës duke iu krijuar atyre mundësi për të trajnuar, vlerësuar dhe rekrutuar punëtorë të mundshëm në të ardhmen me një kosto të arsyeshme.

Të nxënit nëpërmjet projekteve

- Krijoni projekte që kërkojnë nga nxënësit të zhvillojnë dhe zbatojnë njohuritë dhe aftësitë që lidhen me prodhimin intensiv dhe organik.
- Shembull: Planifikimi, konceptimi dhe mbjellja e një kopshti intensiv ose organik.

Të nxënit në mjedise pune në botën reale

- Organizoni vizita në ferma organike dhe tradicionale për të mësuar rreth teknikave të përdorura.
- Bashkëpunoni me fermerët vendas për të ofruar përvojë praktike për nxënësit.

Teknologjia dhe aplikacionet digjitale

- Përdorni aplikacione dhe mjete digjitale për të ndihmuar në menaxhimin e fermave, gjurmimin e kulturave bujqësore, analizimin e të dhënave dhe identifikimin e sëmundjeve të bimëve ose për kryerjen e simulimeve të ndryshme.
- Përdorni simulatorët dhe realitetin virtual për organizimin e trajnimit në lidhje me teknikat e ndryshme bujqësore.

Të nxënit nëpërmjet problemeve

- Përcaktoni një problem ose sfidë që duhet të zgjidhet nga nxënësit përmes punës kërkimore dhe praktikës.
- Shembull: Si mund të kontrollohet një sëmundje e caktuar bimore në mënyrë organike?

Angazhimi i ekspertëve të fushës si burime

- Ftoni ekspertë të fushës së bujqësisë organike dhe tradicionale për të ndihmuar në punën për trajnimin e nxënësve, dhe për të dhënë leksione në lidhje me tematika të caktuara.

Të nxënit e ndërlidhur

- Kombinoni njohuritë e marra në lëndë të ndryshme, si biologjia, kimia dhe ekonomia për njohjen më të thellë të aspekteve të bujqësisë.

Vlerësimi i vazhdueshëm dhe i bazuar në performancë

- Vlerësoni aftësitë dhe njohuritë praktike të nxënësve përmes projekteve, prezantimeve dhe demonstrimeve, jo vetëm përmes testeve.

Si përfundim, qasja inovative ndaj të nxëniet nëpërmjet punës fokusohet në krijimin e një mjedisi mësimor sa më afër realitetit të punës në fushën e bujqësisë intensive dhe organike, për t'i ndihmuar nxënësit për t'u përgatitur më mirë dhe për të qenë të gatshëm për tregun e punës.

1.4. Parime/udhëzime të përbashkëta për përgatitjen dhe zbatimin e procesit inovativ të të nxëniet nëpërmjet punës

Mësuesit dhe mentorët e praktikave profesionale duhet t'i përshtatin proceset inovative mësimore me kontekstin dhe nevojat specifike të nxënësve.

Gjatë përgatitjes dhe realizimit të procesit inovativ të të nxëniet nëpërmjet punës, përveç parimeve të përmendura më parë, mund të zbatohen edhe sa vijon:

<p>Të nxëniet aktiv:</p> <ul style="list-style-type: none"> Inkurajimi i nxënësve për t'u angazhuar në mënyrë aktive me materialin mësimor përmes diskutimeve, zgjidhjes së problemeve, punës në grup dhe aktiviteteve praktike. <p>Përdorimi i teknologjisë:</p> <ul style="list-style-type: none"> Integrimi i mjeteve dhe burimeve të duhura teknologjike për të përmirësuar përvojat e të nxëniet. Garantimi i aksesueshmërisë dhe përdorshmërisë për të gjithë nxënësit. <p>Qasja ndërdisiplinore:</p> <ul style="list-style-type: none"> Promovimi i lidhjeve ndërmjet temave të ndryshme dhe aplikacioneve të botës reale. Kultivimi i kreativitetit dhe mendimit kritik. <p>Bashkëpunimi dhe të nxëniet nga njëri-tjetri:</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxitja e bashkëpunimit ndërmjet nxënësve nëpërmjet projekteve në grup dhe të nxëniet nga njëri-tjetri. Inkurajimi i nxënësve për të mësuar nga njëri-tjetri. <p>Përmirësimi i vazhdueshëm:</p> <ul style="list-style-type: none"> Vlerësimi dhe përshtatja e vazhdueshme e metodave dhe materialeve mësimore bazuar në reagimet dhe rezultatet e nxënësve. <p>Informimi i vazhdueshëm në lidhje me studimet dhe tendencat aktuale mësimore.</p>	<p>Zbatimi në botën reale:</p> <ul style="list-style-type: none"> Lidhja e mësimit në klasë me problemet dhe skenarët e botës reale. Demonstrimi i rëndësisë praktike të përmbajtjes së materialeve mësimore. <p>Të menduarit kritik dhe zgjidhja e problemeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> Përgatitja e aktiviteteve që i nxisin nxënësit të mendojnë në mënyrë kritike, të analizojnë informacionin dhe të zgjidhin probleme komplekse. <p>Mësimdhënia multimodale:</p> <ul style="list-style-type: none"> Përfshirja e një shumëllojshmërie metodash mësimore, si leksionet, diskutimet, multimedia dhe të nxëniet nëpërmjet përvojës. <p>Vlerësimi i inovacionit:</p> <ul style="list-style-type: none"> Vlerësimi i suksesit të qasjeve inovative dhe të qenit të gatshëm për t'i përshtatur ose për të hequr dorë nga ato, nëse nuk janë efektive. <p>Komunitetet e të nxëniet:</p> <ul style="list-style-type: none"> Nxitja e ndjenjës së komunitetit tek nxënësit dhe krijimi i mundësive që ata të mësojnë nga njëri-tjetri.
---	--

1.5. Metodatat inovative për procesin e të nxënimit nëpërmjet punës (përdorimi i mekanizimit, pajisjeve dhe mjeteve përkatëse, të të nxënimit ndërdisiplinor, puna individuale dhe në grup, projektet, kërkime praktike, etj.)

Metodat inovative të procesit të të nxënimit nëpërmjet punës përfshijnë një sërë qasjesh ku puna fokusohet në pajisjen e nxënësve me aftësitë përkatëse praktike në mënyrë sa më efektive dhe tërheqëse. Këto metoda bazohen në përdorimin praktik të makinerive, pajisjeve dhe mjeteve përkatëse, si dhe në shfrytëzimin e të nxënimit ndërdisiplinor dhe kombinimin e punës individuale me atë ekipore.

Metodat inovative për procesin e të nxënimit nëpërmjet punës janë:

Integrimi i teknologjisë dhe mekanizimit	Përdorimi i mjeteve dhe makinerive të avancuara në programet e trajnimit i ndihmon nxënësit për të fituar përvojë praktike në lidhje me përdorimin e pajisjeve që do të hasin në fushat e tyre përkatëse. Kjo metodë përfshin përdorimin e simulimeve të realitetit virtual për trajnimin, të robotikës industriale për prodhimin ose të sistemeve të inteligjencës artificiale për teknologjinë e informacionit dhe analizimin e të dhënave.
Qasjet ndërdisiplinore ndaj të nxënimit	Kjo metodë përfshin angazhimin e nxënësve në projekte që kërkojnë njohuri nga disiplina të shumta, gjë që inkurajon njohjen gjithëpërfshirëse të problemeve reale. Për shembull, një projekt mund të kombinojë elementë të fushës së bujqësisë, mjedisit dhe biznesit për të adresuar sfidat që kanë të bëjnë me aspektet e qëndrueshmërisë.
Projektet bashkëpunuese dhe puna ekipore	Projektet ekipore i referohen mjedisve reale të punës ku bashkëpunimi është element kyç. Nxënësit mund të punojnë së bashku për zbatimin e projekteve, duke ndarë aftësitë dhe këndvështrimet e tyre të ndryshme, gjë që përmirëson aftësitë për zgjidhjen e problemeve dhe komunikimin.
Rrugët e të nxënimit të individualizuara	Në këtë metodë përdoren teknologjitë adaptive mësimore, procesi i të nxënimit mund t'i përshtatet aftësive dhe mënyrës së preferuar të individit për të nxënë. Kjo metodë garanton shmangien e mbingarkesës për nxënësit dhe motivimin e mjaftueshëm të tyre për t'u përqendruar në ato fusha ku kanë më shumë nevojë për përmirësim.
Projektet kërkimore praktike	Përfshirja e nxënësve në projekte kërkimore praktike, në bashkëpunim me partnerët e sektorit të industrisë garanton përfundimin e përvojës praktike në fushën e tyre të studimit. Kjo përfshirje mund të variojë nga puna për zhvillimin e kërkimit shkencor në një laborator deri te zhvillimi i një strategjie të re biznesi në mjedisin e korporatave.
Të nxënimit nëpërmjet lojërave dhe të nxënimit ndërveprues	Përdorimi i elementeve të lojës në edukim mund ta bëjë mësimin më tërheqës dhe të paharrueshëm. Këtu mund të përfshihen sfidat konkurruese, sistemet e shpërblimit ose simulimet ndërvepruese që imitojnë skenarë të jetës reale.
Mjetet për mësimin në distancë dhe virtual	Shfrytëzimi i platformave në internet dhe i mjedisve virtuale të mësimin në distancë sigurojnë fleksibilitet dhe qasje tek një gamë

	më e gjerë burimesh dhe ekspertize. Kjo është veçanërisht e dobishme për nxënësit që jetojnë në zona të thella dhe nxënësit me nevoja të veçanta.
Zgjidhja e problemeve në botën reale	Projektet që trajtojnë problemet e botës reale i ndihmojnë nxënësit për të zbatuar njohuritë e tyre në një kontekst praktik. Kjo metodë mund të përfshijë punën me bizneset lokale ose organizatat e komunitetit dhe synon të gjejë zgjidhje për sfidat reale me të cilat përballen.
Praktikat profesionale afatgjata dhe stazhi i punës	Kombinimi i mësimin në klasë me trajnimin në vendin e punës përmes praktikës profesionale afatgjatë ose stazhit të punës i ndihmon nxënësit për të fituar përvojë praktike, për të ndërtuar rrjete profesionale dhe për të kuptuar dinamikën e vendit të punës.
Praktikat e reagimit dhe reflektimit	Inkurajimi i reagimit dhe reflektimit të vazhdueshëm i ndihmon nxënësit të kuptojnë nivelin e përparimit të tyre, të identifikojnë fushat për përmirësim dhe të zhvillojnë aftësitë për të menduarit kritik. Kjo mund të lehtësohet përmes vlerësimit të punës së njëri-tjetrit, programeve të mentorimit dhe mjeteve të vetëvlerësimit.

1.6. Vlerësimi përmblendhës në shkollë dhe vlerësimi i jashtëm i procesit të të nxëniet nëpërmjet punës

Vlerësimi përmblendhës i shkollës dhe vlerësimi i jashtëm i procesit të të nxëniet nëpërmjet punës janë masa thelbësore për të konfirmuar që nxënësit kanë arritur nivelin e kërkuar të kompetencës dhe janë gati për praktikë profesionale në fushat e tyre përkatëse. Vlerësimet përmblendhëse duhet të përputhen me objektivat e të nxëniet të programit të praktikës profesionale, duke siguruar që ato të masin me saktësi rezultatet e synuara. Rezultatet e dala duhet të jenë **të vlefshme** (të masin atë që duhet të masin) dhe **të besueshme** (të qëndrueshme në matjen e tyre). Vlerësimet përmblendhëse duhet t'i ndihmojnë nxënësit për të kuptuar **pikat e tyre të forta dhe fushat ku kanë nevojë për përmirësim**.

Vlerësimi përmblendhës i praktikës profesionale në shkollë

Projektet ose portofolet përfundimtare	Nxënësve mund t'u kërkohej të kryejnë një projekt gjithëpërfshirës ose të hartojnë një portofol për demonstrimin e aftësive dhe njohurive të fituara. Kjo mund të përfshijë projektet kërkimore, detyrat praktike, rastet studimore ose një përmblendje të projekteve të ndryshme më të vogla.
Provimet dhe testet me shkrim	Ata mund të vlerësojnë njohuritë teorike dhe nivelin e njohjes së parimeve dhe koncepteve të mësuara gjatë procesit mësimor.
Provimet praktike	Nxënësit demonstronjë aftësitë e tyre në një mjedis të kontrolluar të botës reale.
Prezantimet me gojë	Nxënësit prezantojnë projektet e tyre ose gjetjet e dala nga puna kërkimore, duke demonstruar jo vetëm njohuritë e tyre në lidhje me lëndën, por edhe aftësitë e komunikimit.
Vlerësimi i punës së njëri-tjetrit	Përfshirja e bashkëmoshatarëve/kolegëve në procesin e vlerësimit për projektet ose prezantimet në grup.
Vlerësimet nga mësuesit	Vlerësime gjithëpërfshirëse nga mësuesit bazuar në një sërë kriteresh, duke përfshirë pjesëmarrjen në klasë, performancën në detyrat praktike dhe përparimin e përgjithshëm.

Vlerësimi përmblendhës i jashtëm i procesit të të nxëniet nëpërmjet punës

Vlerësimet nga sektori i industrisë	Përfshirja e profesionistëve të sektorit të industrisë në punën për vlerësimin e performancës së nxënësve, gjatë praktikës profesionale afatgjatë apo stazhit të punës, duke u fokusuar tek aftësitë praktike dhe sjelljet e tyre në vendin e punës.
Testimi i standardizuar	Vlerësimi nëpërmjet testeve të standardizuara të administruara nga organe të jashtme dhe që synojnë konfirmimin e kompetencave.
Vlerësimi i jashtëm i portofolit	Vlerësimi i jashtëm i portofolit të nxënësve nga profesionistët për të garantuar vlerësimin e paanshëm të aftësive dhe të gatishmërisë së tyre për tregun e punës.
Konkurset e aftësive	Të organizuara në nivel rajonal, kombëtar ose ndërkombëtar, ato mund të shërbejnë si një formë vlerësimi ku nxënësit demonstronjë aftësitë e tyre në kushte konkurrimi.
Provimet e licencimit	Për ato profesione ku nevojitet licencë për ushtrimin e tyre, dhënia e provimit për marrjen e licencës përkatëse është një vlerësim përmblendhës i rëndësishëm.

Vlerësimet nga mësuesit	Vlerësime gjithëpërfshirëse nga mësuesit bazuar në një sërë kriteresh, duke përfshirë pjesëmarrjen në klasë, performancën në detyrat praktike dhe përparimin e përgjithshëm të nxënësve.
--------------------------------	--

Vlerësimi i integruar

Vlerësimet përmblendhëse duhet të integrojnë elementet shkollore dhe ato të jashtme. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në rastet kur praktika profesionale kryhet në biznes nën drejtimin e mentorit përkatës.

1.7. Modelet e dokumentacionit të kërkuar për regjistrimin e procesit të të nxënësve nëpërmjet punës dhe punës praktike

Gjatë zhvillimit të praktikave profesionale, është e nevojshme mbajtja e dokumentacionit përkatës. Këto dokumente ndihmojnë për të garantuar që nxënësit do t'iu sigurohen parakushtet e nevojshme gjatë trajnimit praktik, në mënyrë që ata të fitojnë kualifikimet e nevojshme, por edhe që institucionet dhe subjektet arsimore, ku kryhet trajnimi praktik, të kenë një evidencë të qartë në lidhje me ecurinë dhe performancën e nxënësve.

Dokumentet e nevojshme për monitorimin e procesit mësimor dhe praktikës profesionale janë:

Kontrata e praktikës profesionale në biznes. Një dokument i nënshkruar midis nxënësit, institucionit arsimor dhe biznesit ku kryen praktikën nxënësi, ku specifikohen detyrat, përgjegjësitë dhe objektivat e praktikave profesionale.

Plani i praktikës profesionale në biznes. Ai përcakton objektivat mësimore, aftësitë që duhet të zhvillojë nxënësi dhe detyrat që duhet të kryejë gjatë periudhës së praktikës profesionale.

Ditari/fletorja për dokumentimin e përvojës së nxënësit. Një ditar/fletore që plotësohet nga nxënësit me shënime në lidhje me aktivitetet e përditshme, sfidat, arritjet dhe reflektimet mbi përvojën e tyre.

Vlerësimi i performancës. Formularët e përdorur nga mbikëqyrësit për të vlerësuar performancën e nxënësve bazuar në kritere të paracaktuara.

Vlerësimi ditë. Formularët e plotësuar nga mbikëqyrësi për dhënien e mendimit në lidhje me punën e nxënësit çdo ditë ose javë.

Raporti përfundimtar i praktikës profesionale në biznes. Dokumenti i përgatitur nga nxënësi në fund të periudhës së praktikës profesionale, duke reflektuar mbi përvojat e fituara, detyrat e kryera dhe lidhjen midis praktikës dhe njohurive teorike.

Certifikata e trajnimit. Një vërtetim që konfirmon se nxënësi e ka përfunduar me sukses periudhën e praktikës profesionale.

Evidencat e prezencës/angazhimit. Dokumentet ku regjistrohen orët e punës, detyrat e kryera dhe të gjitha vërejtjet përkatëse për punën e nxënësit.

Portofoli i përvojës. Përmblendhja e punëve, projekteve dhe detyrave të kryera nga një nxënës gjatë periudhës së praktikës profesionale.

Vlerësimi i punës së njëri-tjetrit. Në disa raste, vlerësimi i një nxënësi mund të kryhet edhe nga nxënësit e tjerë, gjë që ndihmon për krijimin e një ideje më të plotë në lidhje me performancën e tij/saj.

2. Aspekte specifike për realizimin e procesit të mentorimit/praktikës profesionale në lidhje me kultivimin e bimëve njëvjeçare

2.1 Kultivimi i bimëve njëvjeçare – Propozimi i praktikave profesionale për të mbështetur arritjen e rezultateve të të nxëniet

Qasjet e të nxëniet nëpërmjet punës

Parimet mbi të cilat do të bazohet praktika profesionale në fushën e kultivimit të bimëve njëvjeçare.

Të nxëniet aktiv	Inkurajimi i nxënësve që të përfshihen aktivisht në aktivitete përmes diskutimeve, zgjidhjes së problemeve, punës në grup dhe aktiviteteve praktike.
Përdorimi i teknologjisë	Integrimi i mjeteve dhe burimeve të përshtatshme teknologjike për të përmirësuar përvojat mësimore. Sigurimi i aksesueshmërisë dhe përdorshmërisë për të gjithë nxënësit.
Bashkëpunimi dhe të nxëniet nga njëri-tjetri	Inkurajimi i bashkëpunimit mes nxënësve përmes projekteve në grup dhe të nxëniet nga njëri-tjetri.
Aplikimi në botën reale	Lidhja e mësimin të zhvilluar në klasë me problemet dhe skenarët e botës reale.
Mendimi kritik dhe zgjidhja e problemeve	Konceptimi i aktiviteteve që i nxisin nxënësit të mendojnë në mënyrë kritike, të analizojnë informacionin dhe të zgjidhin probleme komplekse.

Aftësitë e përftuara në kuadrin e të nxëniet nëpërmjet punës

Aftësitë e përftuara nëpërmjet përfshirjes në praktika profesionale janë si më poshtë:

- gjetja e zgjidhjeve për problemet që lindin në vendin e punës bazuar në njohuritë teorike dhe praktike;
- menaxhimi i vetes dhe i të tjerëve;
- transferimi i njohurive, aftësive dhe kompetencave ekzistuese në kontekste të reja.

Aftësitë në lidhje me punën

Aftësitë e nevojshme që do të përftoni përmes praktikave profesionale në biznes për kryerjen e një pune të caktuar:

- planifikimi i veprimit;
- vendosja e objektivave;
- menaxhimi i projektit;
- vetëvlerësimi;
- puna në ekip.

Aspekte specifike për realizimin e mentorimit/procesit të të nxënësve nëpërmjet punës/praktikave profesionale në lidhje me kultivimin e bimëve njëvjeçare

Trajnimi praktik i nxënësve për kultivimin e kulturave njëvjeçare duhet të lidhë njohuritë e marra nëpërmjet lëndëve profesionale teorike me aftësitë praktike dhe të plotësojë procesin e përvetësimit të kompetencave të nevojshme të nxënësve. Realizimi i trajnimit praktik do të ndjekë procesin teknologjik të kultivimit të kulturave njëvjeçare, duke zbatuar masat agroteknike, operacionet e punës, aktivitetet në teknologjitë e prodhimit, të cilat janë parashikuar në planin e prodhimit të përgatitur më parë.

Trajnimi praktik do të përfshijë si më poshtë:

- përgatitja e hapësirave për kultivimin e kulturave bujqësore njëvjeçare;
- mbjellja e farave, mbjellja e bimëve dhe e fidanëve të kulturave bujqësore;
- marrja e masave për kujdesin ndaj kulturave bujqësore;
- vjelja, transportimi, magazinimi i produkteve bujqësore;
- përpunimi dhe marrja e produkteve të thjeshta.

2.2 Kultivimi i bimëve njëvjeçare – burimet e nevojshme dhe nevojat e nxënësve

Për të realizuar trajnimin praktik të nxënësve në fushën e kultivimit të kulturave bujqësore njëvjeçare, është e nevojshme të identifikohen dhe të sigurohen burimet e nevojshme për të përmbushur kërkesat mësimore dhe praktike të nxënësve.

Burimet e nevojshme për realizimin e trajnimit praktik të nxënësve për kultivimin e kulturave bujqësore njëvjeçare:

- Tokë bujqësore ose serrë: për përvojë praktike në fushën e kultivimit të bimëve;
- Makineri bujqësore, vegla dhe pajisje;
- Farat, fidanët dhe materiali mbjellës bimor;
- Laborator bujqësor: për analiza dhe demonstrime praktike;
- Mjetet për kujdesin ndaj kulturave bujqësore;
- Pajisjet për transportin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore;
- Pajisjet për përpunimin e produkteve bujqësore;
- Programi kompjuterik për menaxhimin e fermës: ndihmon për planifikimin dhe monitorimin e aktiviteteve.

Nevojat e nxënësve në drejtim të zbatimit të praktikës profesionale për kultivimin e kulturave bujqësore njëvjeçare:

- Trajnim specifik për përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve;
- Udhëzime të qarta dhe të strukturuar;
- Mentorimi dhe mbështetja e vazhdueshme nga ekspertët të fushës;
- Materialet mësimore (tutoriale, video, raste studimore, etj.);
- Materialet dhe burimet e vetëstudimit;
- Trajnim për çështjet e sigurisë;
- Edukimi për praktikën e kopshtarisë të qëndrueshme dhe miqësore me mjedisin;
- Zhvillimi i aftësive të të menduarit kritik në kontekstet bujqësore;

- Mundësitë për të punuar në ekip, për të përmirësuar aftësitë e komunikimit dhe të bashkëpunimit;
- Reagimet/mendimet konstruktive nga mentorët dhe instruktorët;
- Përshtatshmëria dhe rezilienca.



Figura 1: Nxënësit gjatë praktikës profesionale për kopshtarinë në ekonominë e shkollës

Burimi: Foto origjinale e autorit

2.3 Kultivimi i bimëve njëvjeçare - shembull i detajuar

Planifikimi i mësuesit për trajnimin praktik

Tema/moduli: *Mbjellja e farave, mbjellja e bimëve dhe fidanëve*

Rezultatet e të nxënit të standardit rajonal të kualifikimit për teknikun bujqësor të kultivimit tradicional dhe organik, mbi të cilat bazohet tema/moduli:

- Prodhon fara të bimëve të ndryshme dhe material mbjellës bimor për përdorim vetjak.
- Merr masa të ndryshme përgatitore dhe zbaton metoda kultivuese për mbjelljen e farave dhe fidanëve në fusha dhe mjedis të mbrojtur/kontrolluar, duke përdorur mjete të përshtatshme për punë në përputhje me standardet dhe rregulloret përkatëse.

Tema mësimore: Mbjellja e grurit

Modeli: Planifikimi i mësuesit për trajnimin praktik

Numri i orëve mësimore: 4		Data: 20.10.2023
Vendi i realizimit: Fermë bujqësore – AgroMix		
Emri i veprimtarisë: Mbjellja e grurit		
Përmbajtja dhe përshkrimi i aktiviteteve: Mbjellja e grurit në një sipërfaqe prej 5 ha, varieteti Pobeda (Victory)		
Njohuritë e nxënësve	<ul style="list-style-type: none"> • Materiali faror • Vetitë cilësore të materialit faror • Përgatitja e materialit faror për mbjellje • Mbjellja e farës • Mënyrat e mbjelljes së farës • Koha e mbjelljes së farës • Thellësia e mbjelljes së farës • Shkalla e farëzimit 	
Materiali i nevojshëm	1,200 kg material farë gruri i varietetit Pobeda, riprodhimi i varietetit I	
Pajisjet dhe mjetet e nevojshëm	Peshore Mekanizimi (traktor dhe makinë mbjellëse) Makineri për mbjelljen e bimëve Vegla dore Metër matës	
Mbrojtja dhe pajisjet	Pajisje, veshje mbrojtëse teknike dhe higjienike, doreza	
Nxënësi	Roli Zbatimi praktik i detyrës së dhënë sipas planit të mbjelljes së farës, i përgatitur gjatë mësimit dhe ushtrimeve të lëndës profesionale teorike.	Kontributet Lidhja e njohurive teorike me aftësitë praktike për mbjelljen e farave të kulturave bujqësore. Organizimi i burimeve dhe punëtorëve për mbjelljen me makineri.
Mësuesi	Roli Monitorimi i aktiviteteve të	Kontributet Lidhja e njohurive të përfutuara nga

	nxënësve gjatë procesit të punës dhe dhënia e udhëzimeve sipas nevojës.	nxënësit në lëndët profesionale teorike për mbjelljen e kulturave bujqësore me punën praktike.
Mentori/punonjësi i biznesit	Roli Pjesëmarrja aktive në punën për kryerjen e detyrës së caktuar dhe dhënia e udhëzimeve sipas nevojës.	Kontributet Kryerja e saktë e procesit të mbjelljes së kulturave bujqësore dhe fitimi i aftësive të nevojshme praktike.
Njohuritë e nevojshme të nxënësve	Teknologjia e mbjelljes së grurit	
Përshkrimi i mënyrës së kryerjes së operacioneve të punës	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Pranimi i detyrës së punës ✓ Leximi i planit për mbjelljen e farës ✓ Përgatitja për punë (pajisjet mbrojtëse personale, masat mbrojtëse) ✓ Zgjedhja dhe peshimi e materialit të farës ✓ Kontrollimi i makinerisë të mbjelljes së farës ✓ Nisja e punës për mbjelljen e farës ✓ Kontrollimi i punës gjatë mbjelljes së farës ✓ Gjetja dhe heqja e pengesave gjatë mbjelljes së farës ✓ Kontrollimi i cilësisë së mbjelljes së farës ✓ Pastrimi dhe ruajtja e makinerive dhe pajisjeve pas mbjelljes së farës ✓ Regjistrimi i aktivitetit të përfunduar 	
Koha e nevojshme për kryerjen e aktiviteteve	4 orë	
Dhënia e udhëzimeve	Nxënësve u jepen udhëzime për secilin prej hapave që duhet të ndiqen gjatë procesit të punës.	
Konkluzionet	Hidhen pas përfundimit të aktivitetit	
Vlerësimi	Hidhet pas përfundimit të aktivitetit	
Reagimi/mendimi	Hidhet pas përfundimit të aktivitetit	

Lista e kontrollit për vlerësimin e trajnimit praktik "Mbjellja e grurit"

Shpjegim:

Më poshtë gjeni listën e kontrollit që do të përdoret për të vlerësuar aktivitetin e nxënësit gjatë kryerjes së detyrës për mbjelljen e grurit. Vlerësimi kryhet thjesht duke treguar nëse nxënësi i ka kryer të gjitha hapat e veprimtarisë. Nëse një nxënës nuk ka ndjekur asnjë nga hapat, vendoset shënimi "jo" dhe mësuesi shpjegon arsyen me anën e një komenti.

Formulari: Lista e kontrollit për vlerësimin e trajnimit praktik "Mbjellja e grurit"

Aktiviteti/treguesi	Po	Jo	Koment
Zhvillimi i një plani të detajuar për mbjelljen e grurit.			
Përdorimi i veshjeve mbrojtëse dhe marrja e masave mbrojtëse.			
Zgjedhja e varietetit të duhur.			
Sasia e saktë e peshuar e materialit të farës.			
Kontrolli i makinerisë së mbjelljes së farës.			
Nisja në mënyrën e duhur e procesit për mbjelljen e grurit.			
Inspektimi i punës gjatë mbjelljes së farës.			
Reagimi i duhur ndaj disa pengesave që shfaqen gjatë mbjelljes.			
Kryerja e inspektimit të cilësisë së mbjelljes.			
Pastrimi dhe ruajtja e makinerive dhe pajisjeve pas mbjelljes.			
Regjistrimi i aktiviteteve të përfunduara.			

Mendimi i mësuesit/mentorit për cilësinë e punës

Mësuesi/mentori jep mendimin e tij në lidhje me mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë nga ana e nxënësit.

Shënimet e mësuesit/mentorit

Hedhja e komenteve të mësuesit/mentorit.

Vlerësimi i arritjeve të nxënësit:

Këtu bëhet vlerësimi për të gjithë ecurinë e veprimtarisë.

Mësuesi/mentori

Plani i mentorit në kompaninë e biznesit

Njësitë modulare, rezultatet e të nxënit, kriteret e vlerësimit dhe vendi i zbatimit të praktikës profesionale në biznes/mësimin praktik të nxënësve në biznes.

Profesioni/Spektori: Bujqësi-Veterinari/Bujqësi, Peshkim dhe Mjekësi Veterinare

Profili Arsimor/Kualifikimi: Teknik Bujqësor për Kultivimin Tradicional dhe Organik

Viti shkollor:

Njësitë modulare	Rezultatet e të nxënit	Kriteret e vlerësimit	Vendi i realizimit	Arritur	
				Po	Jo
Njësia modulare 1: Përgatitja për praktikën profesionale	1. Përdor dokumentacionin e duhur gjatë procesit të praktikës profesionale.	Liston të drejtat dhe detyrimet në përputhje me kontratën për kryerjen e praktikës profesionale në biznes.	Zyrë		
		Mban një ditare/fletore pune.	Zyrë		
		Identifikon mjetet për vlerësimin e arritjeve.	Zyrë		
	2. Zhvillon aftësi të buta ndërsa mëson duke bërë.	Përdor mënyrën e duhur të komunikimit në vendin e punës.	Zona/stacioni i punës		
		Zbaton stilet e të nxënit gjatë praktikës profesionale.	Zona/stacioni i punës		
		Vepron në përputhje me kërkesat për zbatimin e rregulloreve dhe standardeve të ICC-së për mbrojtjen e mjedisit dhe sigurinë në punë.	Zona/stacioni i punës		
	2. Identifikon vendin e punës dhe biznesin pritës.	Përshkruan organizimin e punës.	Zona/stacioni i punës		
		Përshkruan pozicionet e punës.	Zona/stacioni i punës		
		Zgjedh biznesin dhe një vend pune.	Zona/stacioni i punës		
	Njësia modulare 2: Mbjellja e farës dhe mbjellja e bimës	1. Llogarit sasinë e farës, përcakton mënyrën e mbjelljes dhe mbjell kulturat bujqësore.	Identifikon vetitë e cilësisë së farës.	Zona/stacioni i punës	
Demonstron procedurën për testimin e cilësisë së farës.			Zona/stacioni i punës		
Përgatit farën për mbjellje.			Zona/stacioni i punës		
Krahason metodat e mbjelljes.			Zona/stacioni i punës		
Përcakton kohën, thellësinë dhe shkallën optimale të farës për mbjelljen e kulturave bujqësore.			Zona/stacioni i punës		
Mbjell kulturat bujqësore.			Sipërfaqja e punës		
Kontrollon cilësinë e mbjelljes së kryer.			Sipërfaqja e punës		

Formulari: Formulari i pikëve për vlerësimin e punës së nxënësit nga mentori

Numri	Elementet e vlerësimit	Pikët që mund të merrni	Pikët e dhëna nga mentori
1.	Pavarësia sa i takonit planifikimit gjatë punës dhe krijimit të detyrave.	0 - 10	
2.	Kohëzgjatja e punës.	0 - 05	
3.	Rendi dhe korrektësia e procedurave dhe përdorimi i mjeteve.	0 - 10	
4.	Cilësia dhe saktësia e prodhimit.	0 - 30	
5.	Pamja estetike e produktit.	0 - 10	
6.	Përdorimi i dokumentacionit tekniko-teknologjik.	0 - 05	
7.	Zbatimi i masave për punë të sigurt dhe të mbrojtur.	0 - 05	
8.	Zbatimi i rregulloreve dhe procedurave për mbrojtjen e mjedisit.	0 - 05	
9.	Përdorimi racional i burimeve dhe materialeve.	0 - 05	
10.	Komunikimi në punë me kolegët, eprorët dhe klientët.	0 - 10	
11.	Aftësia për të analizuar punën e kryer.	0 - 05	
Gjithsej		100	

VLERËSIMI NUMERIK	NUMRI I PIKËVE
Shkëlqyeshëm (5)	90 – 100
Shumë mirë (4)	75–89
Mirë (3)	62 – 74
Mjaftueshëm (2)	50 – 61



Formular: Lista e elementeve të gatishmërisë së nxënësit për të filluar praktikën profesionale në biznes/ trajnimin praktik në biznes

Numri rendor	Elementet e gatishmërisë	Plotësimi i kërkesave ("v"ose "-")	Vërejtje
1.	Veprimtaria e biznesit ku do të kryejë praktikën profesionale nxënësi është i përshtatshëm me drejtimin mësimor që ndjek nxënësi.		
2.	Kontrata e lidhur – e nënshkruar nga prindërit, drejtori i shkollës dhe drejtuesi i biznesit.		
3.	Kryerja e inspektimit sanitar.		
4.	Nxënësi është i informuar në lidhje me veprimtarinë e biznesit, vendndodhjen, mentorin si dhe politikën e punës së atij biznesi.		
5.	Nxënësi është i informuar në lidhje me mënyrën e veshjes – uniformën e punës, kohën e pushimeve, si dhe orën dhe mënyrën e transportit të punonjësve nga stacioni në vendin e punës dhe anasjelltas.		
6.	Nxënësi ka përgatitur një ditar/fletore pune ku do të shënojë të gjitha detyrat që do të kryejë në biznes.		

Mentori: _____

Biznesi ku ai/ajo punon: _____

Data e mësimit: _____

2.4 Kultivimi i bimëve njëvjeçare - shembull i detajuar i materialeve të ndryshme mësimore

Fletë pune për praktikat profesionale në lidhje me kultivimin e bimëve njëvjeçare

Fleta e punës fokusohet në punën për orientimin e mentorit përmes procesit të lehtësimit, vëzhgimit dhe dhënies së mendimit për nxënësit e përfshirë në aktivitete praktike që lidhen me kultivimin e bimëve njëvjeçare.

Objektivi: Përftimi i aftësive nga ana e nxënësve për kultivimin e bimëve njëvjeçare.

Tabela 1: Fletë pune për praktikat profesionale në lidhje me kultivimin e bimëve njëvjeçare

Pjesa 1: Pasqyra e aktiviteteve	<ul style="list-style-type: none"> • Veprimtari/detyrë e planifikuar • Objektivat e veprimtarisë • Përshkrimi i burimeve të përfshira
Pjesa 2: Përgatitja e mentorit	<ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaritë kryesore që duhen demonstruar ose theksuar • Trajnim për sigurinë dhe mbrojtjen në punë
Pjesa 3: Monitorimi i performancës së nxënësve	<ul style="list-style-type: none"> • Realizimi i detyrave të ngarkuara nga nxënësit • Teknikat dhe aftësitë e aplikuara nga nxënësit
Pjesa 4: Sfidat e nxënësve dhe zgjidhja e problemeve	<ul style="list-style-type: none"> • Sfidat me të cilat përballen nxënësit • Qasja e nxënësve ndaj zgjidhjes së problemeve
Pjesa 5: Siguria dhe qëndrueshmëria në praktikë	<ul style="list-style-type: none"> • Monitorimi i praktikave të sigurisë • Përdorimi i metodave të qëndrueshme nga nxënësit
Pjesa 6: Angazhimi dhe qëndrimi i nxënësve	<ul style="list-style-type: none"> • Niveli i angazhimit të nxënësve • Qëndrimi ndaj mëimit dhe detyrave
Pjesa 7: Reagimet dhe udhëzimet e mentorit	<ul style="list-style-type: none"> • Reagime në lidhje me kryerjen e detyrave • Dhënia e sugjerimeve për orientim dhe përmirësim

Burimet digjitale që mund të përdoren gjatë praktikës profesionale dhe vlerësimit të saj

Burimet digjitale mund të përmirësojnë shumë përvojat e të nxënësve nëpërmjet punës, duke ofruar informacion interaktiv, të aksesueshëm dhe të përditësuar.

Platformat e kurseve në internet	Platforma të tilla si <i>Coursera</i> , <i>Udemy</i> ose <i>edX</i> ofrojnë kurse për fushën e bujqësisë, botanikës dhe shkencës mjedisore, të cilat mund të plotësojnë praktikën profesionale.
Baza e të dhënave bujqësore dhe buletinet	Qasja tek bazat e të dhënave shkencore si <i>JSTOR</i> , <i>ScienceDirect</i> ose <i>Agricola</i> e Departamentit Amerikan të Bujqësisë për studimet më të fundit në fushën e kultivimit të bimëve bujqësore.
Aplikacionet celulare	Aplikacione të tilla si <i>Plantix</i> ose <i>Agrobase</i> për identifikimin e sëmundjeve dhe dëmtuesve të bimëve. Aplikacionet <i>Gardening Companion</i> që ndjekin kalendarët e mbjelljes, rritjen dhe nevojat për ujitje.
Programet kompjuterike interaktive	Program kompjuterik për simulimin e kulturave bujqësore për të kuptuar efektet e variablave të ndryshëm në procesin e rritjes së bimëve. Mjetet për planifikimin e kopshteve si <i>GrowVeg</i> ose <i>Smart Gardener</i> për të konceptuar dhe planifikuar organizimin e kulturave bujqësore.
Realiteti virtual (VR) dhe Realiteti i Shtuar (AR)	Përvoja nëpërmjet VR-së për turne virtuale në mjedise të ndryshme bujqësore. Aplikacionet e AR-së për mbivendosjen e informacionit mbi skenarët e kultivimit në botën reale.

Mjetet digjitale për vlerësimin e programit të praktikave profesionale

Gjatë zgjedhjes së mjeteve digjitale për vlerësimin e një programi të praktikës profesionale, është e rëndësishme të merren parasysh qëllimet specifike të programit, aftësitë dhe kompetencat që po zhvillohen dhe niveli i mbështetjes teknike në dispozicion.

<i>Platformat e Portofolit Elektronik</i>	<i>Mahara</i> ose <i>Portofolium</i> : Portofolët elektronikë i ndihmojnë nxënësit për të dokumentuar dhe demonstruar udhëtimin e tyre të të nxënit, duke përfshirë projektet, aftësitë dhe kompetencat e fituara. Këto mund të rishikohen për të vlerësuar rritjen e nxënësve dhe zbatueshmërinë e aftësive të përftuara.
<i>Platforma të personalizueshme të vlerësimit</i>	<i>Qualtrics</i> ose <i>Typeform</i> : Këto platforma mund të personalizohen për të gjeneruar vlerësime të hollësishme që përputhen me objektivat specifike të programit të praktikës profesionale.

3. Aspekte specifike për realizimin e procesit të mentorimit/praktikës profesionale në lidhje me kultivimin e bimëve shumëvjeçare

3.1 Kultivimi i bimëve shumëvjeçare – Propozimi i programit të praktikës profesionale në biznes për të mbështetur arritjet e Rezultateve të të Nxënit

Qasjet e procesit të të nxënit nëpërmjet punës

Aftësitë e nevojshme në botën e sotme të biznesit janë shumë të ndryshme; plotësimi i kërkesës për aftësi vetëm me modelin tradicional të shkollës mund të jetë i vështirë. Në një model të praktikës profesionale, shkollat trajtojnë aspektet teorike në klasë si dhe ofrojnë trajnime dhe mbështetje teknike në shtegun përkatës të karrierës së një nxënësi, dhe bizneset u ofrojnë nxënësve mundësinë për të përjetuar dhe zotëruar aftësitë e tyre në një mjedis praktik. Përvojat e përfshirjes në praktika profesionale janë nga më të ndryshmet, duke filluar nga mentorimi i nxënësve në shkollë deri te sistemimi në punë ose praktika në biznes. Përvojat e praktikave profesionale të ofruara me ndërveprimin e biznesit krijojnë mundësi për trajnimin në lidhje me aspektet teknike, gjë që është e vështirë të arrihet në klasë. Praktikant profesional i pajisin nxënësit me njohuritë dhe aftësitë e duhura për të qenë sa më të suksesshëm në vendin e punës. Të nxënit nëpërmjet punës është një përvojë e strukturuar mësimore që integron procesin e të nxënit në klasë me përvojën e punës. Ajo ofron mundësi për të rinjtë që të fillojnë të përgatiten për karrierën e tyre ndërsa janë ende në shkollë të mesme. Regjistrimi në një drejtim mësimor profesional në vitin e parë dhe të dytë i përgatit nxënësit për një përvojë të suksesshme gjatë praktikave profesionale. Zhvillimi efektiv i të nxënit përfshin të nxënit nëpërmjet punës dhe aftësitë e lidhura me punën.




Figura 2. Tre rrrathët e edukimit bujqësor.

Burimi:

<https://www.teamaged.co/CMDocs/IowaTeamAgEd/ICAE-Annual-Report-2019.pdf>

AGRICULTURAL EDUCATION - ARSIMI BUJQËSOR
CLASSROOM & LABORATORY INSTRUCTION – MËSIMI NË
 KLASË & LABORATOR
WORK-BASED LEARNING (SAE, internships, etc.) - TË
 NXËNIT NËPËRMJET PUNËS (SAE, praktika profesionale,
 etj.)
CAREER AND TECHNICAL STUDENT ORGANISATIONS (FFA,
 PAS, etc.) - ORGANIZATAT PROFESIONALE DHE TEKNIKE TË
 NXËNËSVE (FFA, PAS, etj.)

Aftësitë e përfutuara gjatë përfshirjes në procesin e të nxënësve nëpërmjet punës

Gjen zgjidhje për problemet që shfaqen në vendin punës bazuar në teori dhe praktikë; e përdor vendin e punës si burim mësimor; menaxhon veten (dhe të tjerët); reflekton në lidhje me ato që ka mësuar në vendin e punës; bën transferimin e njohurive, aftësive dhe kompetencave ekzistuese në kontekste të reja.

Aftësitë në lidhje me punën

Planifikimi i veprimit, kontributi në takime, sipërmarrja, vendosja e objektivave, negociimi, rrjetëzimi, menaxhimi i projektit, vetëvlerësimi, puna ekipore, përdorimi i konsulentit dhe luajtja e rolit të konsulentit.

Aspekte specifike për realizimin e mentorimit/procesit të të nxënësve nëpërmjet punës në lidhje me kultivimin e bimëve shumëvjeçare

Programi i praktikave profesionale duhet të ofrojë përvojë praktike për nxënësit, duke iu dhënë atyre mundësinë për të përdorur njohuritë e fituara teorikisht në një mjedis real pune. Ky program synon të njohë nxënësit me bimët shumëvjeçare, të ofrojë aftësi praktike për kultivimin e tyre dhe të ndihmojë për njohjen e sfidave dhe mundësive të sektorit. Pjesëmarrja aktive dhe puna në fusha të mirëfillta do t'i ndihmojë ata për të thelluar njohuritë e tyre në lidhje me këtë fushë.

Programi do të ndahet në disa faza, të cilat përfshijnë:

- **Faza 1:** Njohuri teorike për bimët shumëvjeçare.
- **Faza 2:** Eksperiencë praktike në ferma kooperativiste.
- **Faza 3:** Përdorimi i njohurive në projekte dhe situata të ndryshme.
- **Faza 4:** Reflektimi dhe përmirësimi i aftësive të fituara.

Gjatë këtyre fazave, nxënësit do të fitojnë njohuri të qarta në lidhje me sfidat, teknikat dhe mjetet e përdorura në procesin e kultivimit të bimëve shumëvjeçare.



Figura 3. Nxënësit gjatë realizimit të praktikës profesionale.

Burimi: <https://www.nymparents.com/article/families-can-learn-about-farming-practices-at-westchester-farms>

3.2 Kultivimi i bimëve shumëvjeçare – burimet e nevojshme dhe nevojat e nxënësve

Burimet e nevojshme:

- Fushat aktuale bujqësore për kryerjen e praktikës profesionale;
- Mjetet dhe pajisjet e kultivimit;
- Materiale mësimore dhe literaturë;
- Mjetet digjitale dhe aplikacionet përkatëse;
- Laborator bujqësor: për analiza dhe demonstrime praktike;
- Program kompjuterik për menaxhimin e fermës: për të ndihmuar në punën për planifikimin dhe monitorimin e aktiviteteve;
- Ekspertët e fushës dhe mentorët: për orientim dhe mbështetje gjatë procesit mësimor.

Nevojat e nxënësve:

- Trajnim specifik për përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve;
- Udhëzime të qarta dhe të strukturuar;
- Mentorim dhe mbështetje e vazhdueshme nga ekspertë të fushës;
- Trajnim praktik: Nxënësit kanë nevojë për përvojë të drejtpërdrejtë në terren për të kuptuar problematikat e procesit të kultivimit;
- Sesione diskutimi: diskutim në lidhje me sfidat, arritjet dhe përvojat e tyre gjatë praktikës profesionale;
- Materialet mësimore: udhëzime të detajuara, videoklipe, raste studimore, etj.;
- Materialet dhe burimet për vetë - studim.

3.3 Kultivimi i bimëve shumëvjeçare - shembull i detajuar

Formulari i planifikimit të mësuesit për trajnimin praktik

Tema/moduli: *Shartimi i pemëve frutore dhe hardhive*

Rezultatet e të nxëniet për standardin rajonal të kualifikimit të teknikut bujqësor të kultivimit tradicional dhe organik mbi të cilin bazohet tema/moduli: *Prodhon material mbjellës bimor të pemëve drufrutore dhe hardhive për përdorim vetjak.*

Tema mësimore: Shartimi i drufrutorëve/hardhisë

Formulari: Formulari i planifikimit të mësuesit për trajnimin praktik

Numri rendor i orës mësimore: X	Data/...../20.....	
Vendi i realizimit: Pemëtore/vreshtë në fermë		
Emri i veprimtarisë: Shartimi i drufrutorëve/hardhive		
Përmbajtja dhe përshkrimi i punës: <ul style="list-style-type: none"> • Mjetet e nevojshme për shartim; • Materiali i nevojshëm për shartim; • Shartimi i një peme me sytha; • Shartimi i një drufrutori me prerje kalem; • Mbjellja e fidanëve në fidanishte; • Shërbimet e kujdesit ndaj fidanëve pas shartimit. 		
Njohuritë e nevojshme të nxënësve	<ul style="list-style-type: none"> • Metodat dhe teknikat e shartimit të drufrutorëve dhe të hardhive; • Mjetet dhe materialet e nevojshme për shartimin e fidanëve; • Shërbimet dhe kujdesi i nevojshëm pas shartimit; 	
Materiali i nevojshëm për punë	<ul style="list-style-type: none"> • Materiali mbjellës bimor, nënshartesat dhe shartesat; • Brisqet e shartimit, gërsërët krasitëse, veglat krasitëse; • Materialet lidhëse të sythave; • Materiali izolues i nënshartesës dhe i kalemave; • Materiali lidhës për fidanët; 	
Pajisjet dhe mjetet e nevojshme për punë	<ul style="list-style-type: none"> • Mjetet e ambalazhimit për vendosjen e nënshartesave dhe shartesave (sytha ose kalema); • Tallash druri për vendosjen e fidanëve të shartuar; • Mjetet për transportimin e fidanëve në fidanishte; • Materialet e etiketimit; • Udhëzime për teknikat e shartimit të fidanëve të drufrutorëve. 	
Mbrojtja e nevojshme Mjetet/Masat mbrojtëse dhe pajisjet	<ul style="list-style-type: none"> • Përparëse pune • Doreza pune • Çizme llastiku • Udhëzime për sigurinë në punë dhe masat mbrojtëse për mbrojtjen e shëndetit dhe mjedisit të tyre. 	
	Roli Zbatimi i teknikave të shartimit të	Kontributi Kryen shartimin e fidanëve

Nxënësi	drufrutorëve dhe hardhive me sytha dhe përpajna.	frutorë në shartesore.
Mësuesi	Roli Udhëzon dhe kontrollon punën praktike që do të bëjë nxënësi.	Kontributi Udhëzon nxënësin për të kryer procesin e shartimit sipas mësimëve teorike që ka marrë në klasë.
Mentori	Roli Zbaton dhe kontrollon procesin e shartimit të fidanëve.	Kontributi Kontrollon mënyrën se si e kryen nxënësi procesin e shartimit
Përshkrimi i mënyrës së kryerjes së operacioneve të punës	<ul style="list-style-type: none"> • Përzgjedh mjetet dhe pajisjet e nevojshme të përshtatshme për llojin e fidanëve të drufrutorëve që do të shartohen. • Përzgjedh materialin e nevojshëm për shartim (nënshartesat dhe mbishartesat). • Vendos nënshartesat dhe mbishartesat në tavolinën e punës. • Kryen procesin e shartimit duke prerë kalemin sipas teknikës së duhur. • Pas vendosjes së sythit ose kalemit mbi nënshartesën, i lidh ato me materiale lidhëse. • Izolon sythin ose kërcellin me material izolues për ta mbrojtur nga lagështia. • Etiketon fidanët me një etiketë që tregon llojin e pemës frutore, kohën e shartimit etj. • Vendos fidanët e shartuar në arka me tallash. • Dërgon arkat me fidanë të shartuar në shartesore për të garantuar zënien e fidanëve. • Transporton fidanët drejt fidanishtes. • Kryen procesin e mbjelljes së fidanëve në fidanishte. • Zbaton masat agroteknike pas mbjelljes së fidanëve. 	
Koha e nevojshme për të kryer aktivitetin	<ul style="list-style-type: none"> • Katër ditë, ku përfshihet shartimi, koha e qëndrimit në shartesore dhe mbjellja në fidanishte. 	
Dhënia e udhëzimeve	<ul style="list-style-type: none"> • Para fillimit të punës, mësuesi i praktikës dhe mentori japin udhëzime për proceset teknike të procesit të shartimit. 	
Konkluzionet	<ul style="list-style-type: none"> • Mësuesi i praktikës profesionale dhe mentori kontrollojnë mënyrën se si nxënësi kryen procesin e shartimit dhe e orientojnë atë nëse nuk përmbush kërkesat teknike të procesit të shartimit. 	
Vlerësimi	<ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi i punës së nxënësit bëhet me anën e listës së kontrollit, vëzhgimit dhe vetëvlerësimit. 	
Reagimi/mendimi	<ul style="list-style-type: none"> • Dhënia e mendimit nga mësuesi ose mentori për punën e pavarur të nxënësit në procesin e shartimit. Mentori verifikon përvojat e fituara. 	

Demonstrimi

Demonstrimi i krasitjes së pemëve frutore për të stimuluar rritjen dhe prodhimin optimal të frutave.

Demonstrimi i shartimit: Nxënësit do të mësojnë se si të shartojnë drufrutorët dhe hardhitë. Ky demonstrim do të përfshijë përzgjedhjen e degëve për teknikat e shartimit, prerjes dhe bashkimit.

Shembuj të botës reale të punës

Vizitë në një fermë model ku përdoren teknologji të avancuara për kultivimin e rrushit. Kjo vizitë do të shërbejë për të krijuar një ide nga afër dhe të drejtpërdrejtë në lidhje me sfidat dhe mundësitë që ofron tregu aktual.

Vizitë në një fermë të suksesshme që merret me kultivimin e rrushit për të mësuar në lidhje me teknikat e kultivimit dhe të menaxhimit të një ferme të madhe.

Aktivitete praktike

Punë në terren ku nxënësit do të marrin pjesë në procesin e përgatitjes së tokës për mbjelljen e fidanëve të drufrutorëve dhe hardhisë, kujdesin, plehërimin dhe mbrojtjen e bimëve shumëvjeçare. Ato përfshijnë punën në kopshtin e shkollës, përgatitjen e raporteve të frekuentimit dhe testimin e të dhënave laboratorike. Kjo do të ndihmojë për ndërtimin e aftësive praktike dhe njohjen e detajuar të proceseve.

Punë praktike

Nxënësit do të ndihmojnë për kryerjen e punëve të përditshme të një ferme, duke përfshirë veprimtaritë e mëposhtme:

- **Ujitja:** Njohja e sistemeve të ujitjes dhe menaxhimi i tyre.
- **Krasitja dhe formimi i kurorës:** Teknika për të stimuluar prodhimin dhe rritjen e shëndetshme të bimëve
- **Monitorimi:** Përdorimi i teknologjisë për të monitoruar dhe analizuar rritjen e bimëve dhe ndikimin e faktorëve të ndryshëm mjedisorë.
- **Kontrolli i sëmundjeve dhe dëmtuesve:** Identifikimi i dëmtuesve dhe sëmundjeve dhe përdorimi i metodave të mbrojtjes.

Propozimet e projekteve të mundshme

Projekti i optimizimit: Nxënësve do t'iu kërkohet të vënë në jetë njohuritë dhe aftësitë e fituara për të propozuar një plan për optimizimin e një ferme të caktuar që merret me kultivimin e drufrutorëve dhe të hardhive. Kjo mund të përfshijë propozime për kryerjen e ndryshimeve në teknikat e kultivimit, përzgjedhjen e specieve bimore ose përdorimin e teknologjisë dhe metodave organike për të përmirësuar efikasitetin. Projektimi dhe zbatimi i sistemit të ujitjes për një parcelë drufrutorësh.

Vlerësimi

Shpjegim: Në vijim gjeni listën e kontrollit që do të përdoret për të vlerësuar aktivitetin e nxënësve në kuadrin e përmbushjes së detyrës për shartimin e drufrutorëve dhe hardhive. Aktiviteti i nxënësve vlerësohet thjesht duke treguar nëse nxënësi i ka përfunduar të gjitha hapat e aktivitetit. Nëse një nxënës nuk ka përfunduar asnjë nga hapat, vendoset shënimi **jo** dhe mësuesi shpjegon arsyen me anën e një komenti.

Tabela 2: Lista e kontrollit për vlerësimin e trajnimit praktik "Shartimi i drufrutorëve dhe hardhisë"

Aktivitetet/Treguesit	Po	Jo	Koment
Hartimi i një plani të detajuar për shartimin.			
Përdorimi i veshjeve mbrojtëse dhe zbatimi i masave mbrojtëse.			
Zgjedhja e mjeteve dhe pajisjeve të nevojshme dhe të përshtatshme për shartim.			
Zgjedhja e saktë e materialit të nevojshëm për shartim (nënshartesat dhe mbishartesat).			
Kryerja e procesit të shartimit duke prerë kalemin sipas teknikës së duhur.			
Kryerja e procesit të vendosjes së sythit ose të kalemit në nënshartesa, lidhja e tyre me materiale lidhëse dhe izolimi i sythit ose kalemit.			
Etiketimi i fidanëve duke treguar llojin e pemës drufrutore, kohën e shartimit etj.			
Kryerja e procesit të mbjelljes së fidanëve në fidanishte në mënyrën e duhur.			
Zbatimi i masave agroteknike pas mbjelljes së fidanëve sipas teknologjisë.			
Zbatimi i rregullave për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe i masave për mbrojtjen e mjedisit.			
Regjistrimi i aktiviteteve të kryera.			

Opinion për cilësinë e punës

Mësuesi/mentori jep mendimin në lidhje me mënyrën e realizimit të veprimtarisë nga nxënësi sipas hapave.

Komentet e mësuesit/mentorit

Hedhja e shënimeve të mësuesit/mentorit.

Vlerësimi i arritjeve të nxënësve

Vlerësimi i të gjithë ecurisë së aktivitetit.

Vlerësimi nga mësuesi/mentori

Tabela për vlerësimin e nxënësve gjatë praktikës profesionale

Detyrat	Procedurat				
Shartimi i drufrutorëve dhe hardhive	<ul style="list-style-type: none"> • Zgjedhja e mjeteve të nevojshme për shartim; • Zgjedhja e materialit të nevojshëm për shartim; • Shartimi i pemës me syth • Shartimi i pemës me Kalem • Vendosja e fidanëve në fidanishte; • Ofrimi i shërbimeve të kujdesit për fidanët pas shartimit. 				
	Shkalla e zbatimit të procedurave nga nxënësi:				
	Respekton dhe zbaton me saktësi të gjitha procedurat.	Respekton dhe zbaton disa nga procedurat.	Respekton dhe zbaton pjesërisht disa nga procedurat.	Liston procedurat por nuk është i/e aftë për t'i zbatuar ato.	Nuk i plotëson kriteret.
	Vlerësimi				
5	4	3	2	1	



Figura 4. Nxënësit punojnë dhe mësojnë si të shartojnë fidanët.

 Burimi: <https://veggiegardeningtips.com/heirloom-fruit-tree-grafting-workshop/>


Figura 5. Nxënësit punojnë dhe mësojnë si të mbjellin pemë frutore.

 Burimi: <https://www.neallandscapes.co.uk/news/our-top-benefits-of-planting-trees-in-schools>

Plani i mentorit në biznes

Njësitë modulare, rezultatet e të nxënësve, kriteret e vlerësimit dhe vendi i realizimit të të nxënësve nëpërmjet punës /praktikës profesionale në biznes.

Profesioni/Sektori: Bujqësi-Veterinari/Bujqësi, Peshkim dhe Mjekësi Veterinare

Profili Arsimor/Kualifikimi: Teknik bujqësor i kultivimit tradicional dhe organik

Viti shkollor:

Njësitë modulare	Rezultatet e të nxënit	Kriteret e vlerësimit	Vendi i realizimit	Arritjet	
				Po	Jo
Njësia modulare 1: Përgatitja për të mësuar duke bërë	1. Përdor dokumentacionin gjatë procesit të të nxënit nëpërmjet punës.	Liston të drejtat dhe detyrimet në përputhje me kontratën e lidhur me një punëdhënës për kryerjen e praktikës profesionale.	Zyrë		
		Përdor ditarin/fletoren e punës.	Zyrë		
		Identifikon mjetet për vlerësimin e arritjeve.	Zyrë		
	2. Zhvillon aftësitë e buta ndërsa mëson duke bërë.	Përdor aftësitë e duhura të komunikimit në vendin e punës.	Stacioni i punës		
		Zbaton metodat e të nxënit nëpërmjet punës në vendin e punës.	Stacioni i punës		
		Vepron në përputhje me kërkesat për zbatimin e rregulloreve dhe standardeve për mbrojtjen e mjedisit dhe sigurinë në punë.	Stacioni i punës		
	3. Identifikon vendin e punës dhe biznesin pritës	Përshkruan organizimin e punës.	Stacioni i punës		
		Përshkruan pozicionet e punës.	Stacioni i punës		
		Zgjedh një biznes dhe një vend pune.	Stacioni i punës		
Njësia modulare 2: Shartimi i drufrutorëve	1. Zgjedh pajisjet, mjetet dhe materialin e nevojshëm për shartim; sharton dhe etiketon fidanët; transporton dhe mbjell fidanë në fidanishte; zbaton masat agroteknike në vijim të procesit të mbjelljes.	Identifikon materialin e nevojshëm për shartim (nënshartesat dhe kalemata).	Stacioni i punës		
		Sharton fidanët duke përdorur teknikën e duhur.	Stacioni i punës		
		Lidh fidanët e shartuar dhe i izolon ato.	Stacioni i punës		
		Etiketon fidanët dhe i dërgon në objektet përkatëse.	Stacioni i punës		
		Transporton fidanët drejt fidanishtes.	Fidanishte		
		Mbjell fidanë në fidanishte.	Fidanishte		
		Kontrollon cilësinë e procesit të mbjelljes së fidanëve dhe zbaton masat agroteknike për mirëmbajtjen e bimëve në fidanishte.	Fidanishte		
		Zbaton rregullat e sigurisë dhe shëndetit në punë dhe masat për mbrojtjen e mjedisit.	Fidanishte		

Format model: Formulari i pikëzimit i përdorur nga një mentor për të vlerësuar punën e nxënësve

Numri rendor	Elementet e vlerësimit	Pikët që mund të mblidhni	Pikët dhëna nga nga mentori
1.	Pavarësia sa i takon planifikimit gjatë punës dhe krijimit të detyrave.	0 - 10	
2.	Kohëzgjatja e punës.	0 - 05	
3.	Rendi dhe korrektësia e procedurave dhe përdorimi i mjeteve.	0 - 10	
4.	Cilësia dhe saktësia e prodhimit.	0 - 30	
5.	Pamja estetike e produktit.	0 - 10	
6.	Përdorimi i dokumentacionit tekniko-teknologjik.	0 - 05	
7.	Zbatimi i masave për punë të sigurt dhe të mbrojtur.	0 - 05	
8.	Zbatimi i rregulloreve dhe procedurave për mbrojtjen e mjedisit.	0 - 05	
9.	Përdorimi racional i burimeve dhe materialeve.	0 - 05	
10.	Komunikimi në punë me kolegët, eprorët dhe klientët.	0 - 10	
11.	Aftësia për të analizuar punën e kryer.	0 - 05	
Gjithësej		100	

VLERËSIMI NUMERIK	NUMRI I PIKËVE
Shkëlqyeshëm (5)	90 – 100
Shumë mirë (4)	75– 89
Mirë (3)	62 – 74
Mjaftueshëm (2)	50 – 61

Format model: Lista e elementeve që tregojnë nivelin e gatishmërisë së nxënësve për të nisur procesin e të nxënësve nëpunës/praktikën profesionale në biznes.

Numri rendor	Elementet e gatishmërisë	Plotësimi i kërkesave ("v"ose "-")	Vërejtje
1.	Veprimtaria e biznesit ku do të kryejë praktikën profesionale nxënësi është e përshtatshme në raport me drejtimin mësimor ku është regjistruar nxënësi.		
2.	Kontrata e lidhur – e nënshkruar nga prindërit, drejtori i shkollës dhe drejtuesi i biznesit.		
3.	Sigurimi i inspektimit sanitar.		
4.	Nxënësi është i informuar në lidhje me veprimtarinë e biznesit, vendndodhjen, mentorin si dhe politikën e punës të atij biznesi.		
5.	Nxënësi është i informuar në lidhje me mënyrën e veshjes – uniformën e punës, kohën e pushimeve, si dhe orën dhe mënyrën e transportit të punonjësve nga stacioni në vendin e punës dhe anasjelltas.		
6.	Nxënësi përgatit ditarin/fletoren e punës ku do të shënojë të gjitha detyrat e punës që do të kryejë në biznes.		

Mentori: _____

Biznesi ku punon

nxënësi: _____

Data e dorëzimit: _____

3.4 Kultivimi i bimëve shumëvjeçare - shembull i detajuar i materialeve të ndryshme mësimore

Fletë pune për procesin e të nxënimit nëpërmjet punës

Fleta e punës përmban udhëzime të hollësishme për rritjen e drufrutorëve dhe hardhive të rrushit, analizën e tokës dhe udhëzimet për përmirësimin e punës për rritjen e drufrutorëve, kujdesin dhe menaxhimin e bimëve shumëvjeçare, si dhe përfshin listën e mjeteve dhe burimeve të nevojshme për këtë qëllim. Fleta e punës përmban edhe harta mendore, diagrame procesesh, pyetje për diskutim dhe hapësirë për shënime. Kjo do t'i ndihmojë nxënësit të ndjekin dhe reflektojnë mbi përvojat e tyre dhe të identifikojnë çështjet për diskutim dhe studim të mëtejshëm.

Burimet digjitale që mund të përdoren gjatë praktikës profesionale dhe vlerësimit të saj

- Aplikacionet për ndjekjen e kultivimit dhe rritjes së bimëve.
- Platforma në internet për trajnime dhe seminare.
- Baza e të dhënave për sëmundjet dhe dëmtuesit e bimëve shumëvjeçare.
- Program kompjuterik për analizimin dhe monitorimin e të dhënave të mbledhura në terren.
- Video edukative dhe tutoriale që trajtojnë teknika të caktuara kultivimi.
- Forume dhe rrjete sociale ku mësuesit dhe nxënësit mund të diskutojnë dhe të shkëmbejnë përvoja me njëri-tjetrin.




Figura 6. Nxënësit punojnë dhe mësojnë se si të përdorin aplikacionin *Crop Disease Detector* (Detektor i Sëmundjeve të Kulturave)

Burimi: <https://www.mmu.ac.uk/science-engineering/about-us/news/story/index.php?id=6643>



Figura 7. Nxënësit punojnë dhe mësojnë si të vjelin rrushin.

Burimi: <https://world-schools.com/schools/castelli-international-school/>

4. Aspekte specifike për realizimin e procesit të mentorimit/praktikës profesionale për prodhimin blegtoral

4.1 Prodhimi blegtoral – Propozimi i programit të të nxënit nëpërmjet punës për të mbështetur arritjet e Rezultateve të të Nxënit

Qasjet e të nxënit nëpërmjet punës

Parimet mbi të cilat do të bazohet procesi i të nxënit nëpërmjet punës për prodhimin blegtoral.

Të nxënit aktiv	Nxitja e nxënësve për t'u përfshirë aktivisht në aktivitete përmes diskutimeve, zgjidhjes së problemeve, punës në grup dhe aktiviteteve praktike.
Qasja ndërdisiplinore	Promovimi i lidhjeve midis temave dhe aplikacioneve të ndryshme të botës reale. Nxitja e kreativitetit dhe të menduarit kritik.
Bashkëpunimi dhe të nxënit nga njëri tjetri	Nxitja e bashkëpunimit mes nxënësve përmes projekteve në grup dhe të nxënit nga njëri-tjetri. Inkurajimi i nxënësve për të mësuar nga njëri-tjetri.
Përmirësimi i vazhdueshëm	Vlerësimi dhe përshtatja e vazhdueshme e metodave dhe materialeve mësimore bazuar në mendimet dhe rezultatet e nxënësve.
Komunitetet e të nxënit	Nxitja e ndjenjës së komunitetit tek nxënësit dhe krijimi i mundësive që ata të mësojnë nga njëri-tjetri.

Aftësitë e përftuara gjatë praktikës profesionale

Aftësitë që do të zhvillohen përmes të nxënit nëpërmjet punës:

- zbatimi i programeve efektive për ushqyerjen, mbarështimin dhe kujdesin ndaj kafshëve shtëpiake;
- trajtimi i sigurt dhe human i llojeve të ndryshme të bagëtive;
- vetë-menaxhimi dhe menaxhimi i të tjerëve.

Aftësitë e lidhura me punën

Aftësitë që do të zhvillohen përmes të nxënit nëpërmjet punës/praktikës profesionale:

- vendosja e objektivave;
- planifikimi i veprimeve;
- menaxhimi i projekteve;
- vetëvlerësimi;
- puna në grup.



Aspekte specifike të mentorimit/realizimit të të nxënit nëpërmjet punës në lidhje me prodhimin blegtoral

Trajnimi praktik i nxënësve për mbarështimin e kafshëve shtëpiake duhet të lidhë njohuritë e marra nëpërmjet lëndëve profesionale teorike me aftësitë praktike dhe të plotësojë procesin e përfutimit të kompetencave të nevojshme nga nxënësit. Realizimi i trajnimit praktik do të ndjekë procesin teknologjik të mbarështimit të kafshëve shtëpiake, duke zbatuar masat zooteknike, operacionet e punës, aktivitetet në teknologjitë e prodhimit, të cilat janë parashikuar në planin e prodhimit të përgatitur paraprakisht.

Trajnimi praktik do të përfshijë:

- ushqyerjen e kafshëve shtëpiake;
- masat zooteknike;
- grumbullimin, magazinimin dhe ruajtjen e produkteve me origjinë shtazore;
- përpunimin dhe përfutimin e produkteve të thjeshta;

4.2 Prodhimi blegtoral – burimet e nevojshme dhe nevojat e nxënësve

Për të zbatuar trajnimin praktik të nxënësve në fushën e mbarështimit të kafshëve shtëpiake, është e nevojshme të identifikohen dhe të sigurohen burimet e nevojshme për të përmbushur kërkesat mësimore dhe praktike të nxënësve.

Burimet e nevojshme për zbatimin e trajnimit praktik të nxënësve për mbarështimin e kafshëve shtëpiake:

- Objektet për mbarështimin e kafshëve shtëpiake;
- Makineritë, veglat dhe pajisjet bujqësore;
- Zonat e prodhimit të foragjereve;
- Mjetet për kujdesin ndaj kafshëve shtëpiake;
- Pajisjet për grumbullimin, magazinimin dhe ruajtjen e produkteve me origjinë shtazore;
- Pajisjet për përpunimin e produkteve me origjinë shtazore;
- Program kompjuterik për menaxhimin e fermave blegtorale.

Nevojat e nxënësve për realizimin e trajnimit praktik në fushën e prodhimit blegtoral:

- Trajnim specifik për përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve;
- Udhëzime të qarta dhe të strukturuar;
- Mentorimi dhe mbështetja e vazhdueshme nga ekspertë të fushës;
- Materialet edukative (tutoriale, video, raste studimore, etj.);
- Materialet dhe burimet e vetëstudimit;
- Trajnimi për çështjet e sigurisë;
- Mundësi për të punuar në ekip, për të përmirësuar aftësitë e komunikimit dhe të bashkëpunimit;
- Vërejtjet konstruktive nga mentorët dhe instruktorët;
- Përshtatshmëria dhe rezilienca.



Figura 8: Nxënësit gjatë praktikës profesionale në një biznes - përgatitja e ushqimit për lopët e qumështit

Burimi: Foto origjinale e autorit

4.3 Prodhimi blegtoral - shembull i detajuar

Planifikimi i mësuesit për trajnimin praktik/praktikës profesionale

Tema/moduli: *Të ushqyerit e kafshëve shtëpiake*

Rezultatet e të nxënit të standardit rajonal të kualifikimit të teknikut bujqësor të kultivimit tradicional dhe organik në të cilin bazohet tema/moduli: *Garanton ushqyerjen e kafshëve shtëpiake sipas racës dhe kategorisë.*

Tema mësimore: *Ushqyerja e lopëve gjatë ciklit të prodhimit*

Tabela 3: Formulari i planit mësimor për mësuesit e trajnimit praktik

Numri i orës mësimore:		Data
Vendi i realizimit: Fermë bujqësore – fermë me lopë qumështi.		
Emri i aktivitetit: Ushqyerja – Të ushqyerit e lopëve të qumështit gjatë periudhës së laktacionit.		
Përmbajtja dhe përshkrimi i aktiviteteve: Njohja e parimeve të të ushqyerit, balancimi i racioneve, përcaktimi i sasisë dhe cilësisë së foragjereve, përgatitja dhe shpërndarja e ushqimit.		
Njohuritë e mëparshme të nxënësve	Njohuri të fituara për llojet e ushqimit të kafshëve, mënyrat e të ushqyerit të gjedhëve, nevojat e lopëve të qumështit gjatë periudhës së laktacionit.	
Materiali i kërkuar	Llojet e ndryshme të ushqimit.	
Pajisjet dhe aksesoret e nevojshëm	Aksesorë dhe pajisje që përdoren për ushqyerjen e kafshëve.	
Masat dhe pajisjet mbrojtëse	Pajisjet për mbrojtjen higjienike dhe teknike – kominoshe, çizme, doreza	
Nxënësi	Roli Zbatimi praktik i detyrës në përputhje me udhëzimet e dhëna nga mësuesi/mentori.	Kontributi Zgjerimi i njohurive të mëparshme dhe përvetësimi i aftësive të reja gjatë realizimit të detyrës. Dhënia e kontributit për funksionimin më efikas duke marrë pjesë gjatë zbatimit të procedurave teknologjike bashkëkohore.
Mësuesi	Roli Monitorimi i aktiviteteve të nxënësve në procesin e punës dhe dhënia e udhëzimeve sipas nevojës.	Kontributi Përmbledhja e njohurive të nxënësve dhe lidhja e njohurive teorike me aftësitë praktike gjatë zbatimit të procesit të punës - përvetësimi i aftësive nga ana e nxënësve.

Mentori	Roli	Kontributi
	Monitorimi i aktiviteteve të nxënësve në procesin e punës dhe dhënia e udhëzimeve sipas nevojës	Përmbledhja e njohurive të nxënësve dhe lidhja e njohurive teorike me aftësitë praktike gjatë zbatimit të procesit të punës - përvetësimi i aftësive nga ana e nxënësve.
Njohuritë e nevojshme të nxënësve	Teknologjitë që përdoren për ushqyerjen e e lopëve të qumështit.	
Përshkrimi i mënyrës së kryerjes së operacioneve të punës	<ul style="list-style-type: none"> • Përzgjedhja e ushqimeve të kafshëve. • Përcaktimi i cilësisë së ushqimit. • Peshimi i ushqimit. • Përgatitja e ushqimit për shpërndarje. • Shpërndarja e ushqimit. • Monitorimi i procesit të ushqyerjes. 	
Koha e nevojshme për përfundimin e aktivitetit	90 minuta	
Dhënia e udhëzimeve	Nxënësve u jepen udhëzime në lidhje me hapa të caktuar të procesit të punës.	
Konkluzionet	Duhet hedhur pas përfundimit të detyrës.	
Vlerësimi	Duhet hedhur pas përfundimit të detyrës.	
Reagimi/mendimi	Duhet hedhur pas përfundimit të detyrës.	

Formulari për vlerësimin e veprimtarisë praktike/punës

Kryerja e detyrave në lidhje me ushqyerjen e lopëve të qumështit	
Profili arsimor	
Vendi i zbatimit të veprimtarisë	
Emri i detyrës së punës	
Nxënësi	
Mësuesi/mentori	

Shuma e pikëve sipas aspekteve të detyrës së punës						Numri total i pikëve
Aspektet	1.	2.	3.	4.	5.	
Pikët						

Koment

Vendi dhe data:	Mësuesi/mentori
-----------------	-----------------

Formulari i vlerësimit të veprimtarisë praktike/punës

Caktoni numrin e duhur të pikëve për secilin tregues (numri maksimal i pikëve është paraqitur në tabelë)

ASPEKTI: Organizimi i punës

Treguesit (numri maksimal i pikëve): 10	E SAKTË	E PASAKTË
Përgatitja e planit të ushqimit.	4	0
Zgjedhja e makinerive, pajisjeve dhe veglave të përshtatshme.	4	0
Komunikimi me bashkëpunëtorët.	2	0

ASPEKTI: Punimet paraprake

Treguesit (Numri maksimal i pikëve): 10	E SAKTË	E PASAKTË
Zgjedhja e ushqimeve të kërkuara.	4	0
Vlerësimi i cilësisë organoleptike të ushqimit.	4	0
Përgatitja e vendit të punës.	2	0

ASPEKTI: Përgatitja e racioneve dhe ushqyerja e lopëve

Treguesit (numri maksimal i pikëve): 60	E SAKTË			E PASAKTË		
Përdorimi i formulës së paracaktuar.	10			0		
Përzjerja e përbërësve të ushqimit të koncentruar.	10			0		
Zbatimi i teknikës së duhur për ushqyerjen e bagëtive.	20			0		
Monitorimi dhe kontrolli i procesit të të ushqyerit.	10			0		
Kryerja e operacioneve të punës në përputhje me normativën kohore.	deri në __mi n.	deri në __mi n.	maks. __mi n.			
	10	5	0			

ASPEKTI: Mbajtja e evidencave

Treguesit (numri maksimal i pikëve): 10	E SAKTË	E PASAKTË
Hedhja e të dhënave në lidhje me konsumin e ushqimeve individuale për kokë bagëti në formularët përkatës.	4	0
Hedhja e të dhënave në lidhje me konsumin total të ushqimeve individuale në formularët përkatës.	4	0
Hedhja e të dhënave në lidhje me aktivitetin e përfunduar në ditarin/fletoren e punës.	2	0

ASPEKTI: Zbatimi i masave mbrojtëse dhe higjienike

Treguesit (numri maksimal i pikëve): 10	E SAKTË	E PASAKTË
Zbatimi i masave për shëndetin dhe sigurinë në punë të parashikuara për vende të caktuara pune.	3	0
Përdorimi i pajisjeve mbrojtëse personale gjatë punës.	3	0
Hedhja e mbeturinave sipas mënyrës së përcaktuar (materiali bimor dhe materiali i paketimit).	2	0
Ruajtja e higjienës së makinerive, pajisjeve dhe aparaturave.	2	0

Planifikimi i mentorit në kompani biznesi

NJËSITË MODULARE, REZULTATET E TË NXËNIT, KRITERET E VLERËSIMIT DHE VENDI I ZBATIMIT TË PROCESIT TË TË NXËNIT NËPËRMJET PUNËS/PRAKTIKËS PROFESIONALE NË BIZNES

Profesioni/Spektori: Bujqësi-Veterinari/Bujqësi, Peshkim dhe Mjekësi Veterinare

Profili Arsimor/Kualifikimi: Teknik bujqësor i kultivimit tradicional dhe organik

Viti shkollor:

Njësitë modulare	Rezultatet e të nxënit	Kriteret e vlerësimit	Vendi i realizimit	Arritur	
				Po	Jo
Njësia modulare 1: Përgatitja për praktikën profesionale	1. Përdor dokumentacionin e duhur gjatë praktikës profesionale.	Liston të drejtat dhe detyrimet në përputhje me kontratën për kryerjen e praktikës profesionale në biznes.	Zyrë		
		Përdor ditarin/ fletoren e punës.	Zyrë		
		Identifikon mjetet e vlerësimit të arritjeve.	Zyrë		
	2. Zhvillon aftësi të buta gjatë të nxënit duke bërë.	Përdor komunikimin e duhur në vendin e punës.	Zona/stacioni i punës		
		Përdor stilet e të nxënit gjatë punës në vendin e punës.	Zona/stacioni i punës		
		Vepron në përputhje me kërkesat për zbatimin e rregulloreve dhe standardeve të ICC-së për mbrojtjen e mjedisit dhe sigurinë në punë.	Zona/stacioni i punës		
	3. Identifikon vendin e punës dhe biznesin pritës.	Përshkruan organizimin e punës.	Zona/stacioni i punës		
		Përshkruan pozicionet e punës	Zona/stacioni i punës		
		Zgjedh një biznes dhe një vend pune.	Zona/stacioni i punës		
Njësia modulare 3: Teknologjia e qumështit dhe produkteve të qumështit	1. Dallon detyrat e punës nga fusha e prodhimit të qumështit dhe produkteve të qumështit.	Liston vendet e punës në fushën e prodhimit të qumështit dhe produkteve të qumështit.	Impianti i prodhimit		
		Shpjegon detyrat e punës për çdo vend pune në prodhimin e qumështit dhe produkteve të qumështit.	Impianti i prodhimit		
		Analizon kushtet e punës në impiantet e prodhimit të qumështit dhe të produkteve të qumështit.	Impianti i prodhimit		
		Zbaton standardet dhe procedurat standarde operative.	Impianti i prodhimit		
		Zbaton masat dhe rregullat për mbrojtjen në punë.	Impianti i prodhimit		
		Krijon dokumentacion duke u bazuar në aktivitetet përgatitore (studime, vizita, demonstrime, etj.).	Impianti i prodhimit		
	2. Kryen detyra pune në fushën e prodhimit	Lexon grafikët e prodhimit.	Impianti i prodhimit		
		Lexon, interpreton dhe plotëson dokumentacionin që lidhet me procesin teknologjik.	Impianti i prodhimit		

të qumështit dhe produkteve të qumështit .	Kontrollon përmbushjen e kërkesave për zhvillimin e procesit teknologjik.	Impianti i prodhimit		
	Përgatit linjën teknologjike të prodhimit sipas procedurës standard.	Impianti i prodhimit		
	Vlerëson llojet e ndryshme të qumështit në aspektin organoleptic.	Reparti i pritjes së qumështit		
	Monitoron dhe zbaton fazat e procesit të trajtimit termik të qumështit (punon në makinerinë pasterizuese dhe sterilizuese).	Reparti i pasterizimit të qumështit		
	Regjistron temperaturën dhe kohën e pasterizimit dhe sterilizimit.	Reparti i pasterizimit të qumështit		
	Punon në makinerinë mbushëse të qumështit të pasterizuar dhe të sterilizuar.	Reparti i pasterizimit të qumështit		
	Përgatit qumështin për mpiksje.	Impianti i prodhimit		
	Përzgjedh saktë lëndët e para për prodhimin e llojeve të ndryshme të djathit.	Laboratori i kontrollit të qumështit		
	Kjo pasohet me mpiksjen e qumështit dhe marrjen e djathit.	Impianti i prodhimit		
	Formon, preson dhe kripos djathin.	Reparti i prodhimit të djathit		
	Punon për paketimin e djathit.	Reparti i paketimit të djathit		
	Llogarit sasinë e lëndëve të para sipas rregullave dhe recetës për prodhimin e djathit të përpunuar.	Impianti i prodhimit		
	Zbaton faza të caktuara të procesit të prodhimit të djathit të përpunuar.	Impianti i prodhimit		
	Përgatit lëndët e para sipas rregullave dhe recetës për prodhimin e djathit.	Impianti i prodhimit		
	Zbaton faza të caktuara të procesit teknologjik për prodhimin e djathit.	Impianti i prodhimit		
Përdor makineritë dhe pajisjet për marrjen e qumështit të thartë dhe të kosit.	Impianti i prodhimit			

		Ndjek procedurën teknologjike për prodhimin e qumështit të thartë dhe kosit.	Impianti i prodhimit		
		Paketon produktet e qumështit të thartë.	Impianti i prodhimit		
		Regjistron parametrat e rëndësishëm të prodhimit gjatë prodhimit të produkteve të qumështit.	Impianti i prodhimit		
		Njeh kushtet për magazinimin dhe ruajtjen e produkteve të gatshme të qumështit.	Reparti i ruajtjes së produktit të përfunduar		
		Mban evidenca për prodhimin.	Impianti i prodhimit		
		Kontrollon kushtet e ruajtjes për produktet e gatshme.	Reparti i ruajtjes së produktit të përfunduar		
		Zbaton procedurën për pastrimin dhe dezinfektimin e linjës teknologjike dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme.	Impianti i prodhimit		

Formulari: Formulari i pikëve për vlerësimin e punës së nxënësit nga mentori

Numri rendor	Elementet e vlerësimit	Pikët që mund të mbliidhni	Pikët e dhëna nga mentori
1.	Pavarësia sa i takon planifikimit gjatë punës dhe krijimit të detyrave.	0 - 10	
2.	Kohëzgjatja e punës.	0 - 05	
3.	Rendi dhe korrektësia e procedurave dhe përdorimi i mjeteve.	0 - 10	
4.	Cilësia dhe saktësia e prodhimit.	0 - 30	
5.	Pamja estetike e produktit.	0 - 10	
6.	Përdorimi i dokumentacionit tekniko-teknologjik.	0 - 05	
7.	Zbatimi i masave për punë të sigurt dhe të mbrojtur.	0 - 05	
8.	Zbatimi i rregulloreve dhe procedurave për mbrojtjen e mjedisit.	0 - 05	
9.	Përdorimi racional i burimeve dhe materialeve.	0 - 05	
10.	Komunikimi në punë me kolegët, eprorët dhe klientët.	0 - 10	
11.	Aftësia për të analizuar punën e kryer.	0 - 05	
Gjithësej		100	

VLERËSIMI NUMERIK	NUMRI I PIKËVE
Shkëlqyeshëm (5)	90 – 100
Shumë mirë (4)	75–89
Mirë (3)	62 – 74
Mjaftueshëm (2)	50 – 61

Formular: Lista e elementeve të gatishmërisë për të nisur procesin e të nxënësve nëpërmjet punës/ praktikën profesionale në biznes nga nxënësi

Numri rendor	Elementet e gatishmërisë	Plotësimi i kërkesave ("v"ose "-")	Vërejtje
1.	Veprimtaria e biznesit ku kryen praktikën profesionale nxënësi është i përshtatshëm në raport me drejtimin mësimor ku është regjistruar nxënësi.		
2.	Kontrata e lidhur – e nënshkruar nga prindërit, drejtori i shkollës dhe drejtuesi i biznesit.		
3.	Sigurimi i inspektimit sanitar.		
4.	Nxënësi është i informuar në lidhje me veprimtarinë e biznesit, vendndodhjen, mentorin si dhe politikën e punës së atij biznesi.		
5.	Nxënësi është i informuar në lidhje me mënyrën e veshjes – uniformën e punës, kohën e pushimeve, si dhe orën dhe mënyrën e transportit të punonjësve nga stacioni në vendin e punës dhe anasjelltas.		
6.	Nxënësi ka përgatitur një ditar/fletore pune ku shënon të gjitha detyrat e punës që do të kryejë në biznes.		

Mentori: _____

Biznesi ku punon: _____

Data e mësimit: _____

4.4 Prodhimi blegtoral - shembull i detajuar i materialeve të ndryshme mësimore

Fletë pune për procesin e të nxënit nëpërmjet punës në fushën e prodhimit blegtoral

Fleta e punës fokusohet në punën për orientimin e mentorit përmes procesit të lehtësimit, vëzhgimit dhe reagimit ndaj punës së nxënësve të përfshirë në aktivitete praktike që lidhen me mbarështimin e kafshëve shtëpiake.

Objektivi: Përftimi i aftësive nga ana e nxënësve në lidhje me mbarështimin e blegtorisë.

Fletë pune për procesin e të nxënit nëpërmjet punës në fushën e prodhimit blegtoral

Pjesa 1: Pasqyra e aktiviteteve	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Aktivitet/detyrë e planifikuar ✓ Objektivat e aktiviteteve ✓ Përshkrimi i burimeve të përfshira
Pjesa 2: Përgatitja e mentorit	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Aktivitetet kryesore që duhen demonstruar ose theksuar ✓ Trajnim për sigurinë në punë
Pjesa 3: Monitorimi i performancës së nxënësve	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Kryerja e detyrës (Si i kryejnë nxënësit detyrat e caktuara?) ✓ Teknikat dhe aftësitë e përdorura (Çfarë teknikash dhe aftësish vërehen në praktikën e nxënësve?)
Pjesa 4: Sfidat e nxënësve dhe zgjidhja e problemeve	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Sfidat me të cilat përballen nxënësit ✓ Qasja e nxënësve ndaj zgjidhjes së problemeve
Pjesa 5: Siguria dhe qëndrueshmëria në praktikë	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Monitorimi i praktikave të sigurisë ✓ Përdorimi i metodave të qëndrueshme nga nxënësit
Pjesa 6: Angazhimi dhe qëndrimi i nxënësve	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Niveli i angazhimit të nxënësve ✓ Qëndrimi ndaj mësimit dhe detyrave
Pjesa 7: Reagimet dhe udhëzimet e mentorit	<ul style="list-style-type: none"> ✓ Reagime/vlerësime në lidhje me mënyrën e realizimit të detyrës ✓ Sugjerime për orientimin dhe përmirësimin e punës

Burimet digjitale që mund të përdoren gjatë praktikës profesionale dhe vlerësimit të saj

Burimet digjitale mund të përmirësojnë shumë përvojat e të nxëniet nëpërmjet punës (TNP), duke ofruar informacione interaktive, të aksesueshme dhe të përditësuara.

Librat elektronike dhe udhëzuesit në internet	Qasja tek tekstet elektronike dhe udhëzuesit gjithëpërfshirës mbi praktikën bujqësore dhe kujdesin ndaj bimëve njëvjeçare.
Video mësimore dhe uebinare	Video mësimore në <i>YouTube</i> ose <i>Vimeo</i> nga ekspertë të bujqësisë. Uebinarë në lidhje të drejtpërdrejtë të organizuar nga institucione bujqësore ose fermerë me përvojë.
Forumet dhe Komunitetet Online	Pjesëmarrja në forume në internet si <i>The Farmer's Forum</i> ose postimet për kopshtarinë në platformën <i>Reddit</i> për marrjen e mbështetjes dhe këshillave nga komuniteti.
Sistemet e Menaxhimit të të Nxëniet	Platforma si <i>Moodle</i> ose <i>Blackboard</i> për të organizuar materialet e lëndës, për të ndjekur progresin dhe për të lehtësuar komunikimin midis nxënësve dhe mentorëve.
Realiteti Virtual (VR) dhe Realiteti i Shtuar (AR)	Përvoja VR për turne virtuale në mjedise të ndryshme bujqësore. Aplikacionet AR për mbivendosjen e informacionit mbi skenarët e kultivimit në botën reale.

Mjetet digjitale për vlerësimin e programit të praktikës profesionale

Gjatë zgjedhjes së mjeteve digjitale për vlerësimin e një programi të praktikës profesionale (TNP), është e rëndësishme të merren parasysh objektivat specifike të programit, aftësitë dhe kompetencat që zhvillohen dhe niveli i mbështetjes teknike në dispozicion.

Analiza e të nxëniet	Analizimi i të dhënave nga Anketa e Tregut të Punës ose platforma të tjera digjitale për të identifikuar modelet në sjelljet dhe rezultatet e të nxëniet.
Analiza Krahasuese	Krahasimi i rezultateve të TNP-së me dhe pa integrimin e burimeve digjitale për të vlerësuar vlerën e shtuar.

Përvoja e punës - aftësitë dhe njohuritë e fituara nga të qenit i punësuar ose gjatë detyrave të lidhura me profesionin.

Të nxëniet bashkëpunues - përfshin grupe nxënësish që punojnë së bashku për të zgjidhur kolektivisht problemet, për të diskutuar dhe krijuar.

Të nxëniet nëpërmjet eksperiencës - një proces gjatë të cilit nxënësit zhvillojnë njohuri dhe aftësi nga përvoja e drejtpërdrejtë.

Punë në terren - aktivitete mësimore të kryera në mjedise të jetës reale dhe jo në ambientet e klasës.

5. Termat

Kontratë për praktikën profesionale - dokument që rregullon të drejtat dhe përgjegjësitë e të gjithë pjesëmarrësve në praktikën profesionale të nxënësit.

Sistemi dual i arsimit – ofrimi i përbashkët i procesit arsimor nga shkollat dhe punëdhënësit.

Arsimi dual – arsimi profesional, i cili realizohet në dy mjedise mësimore.

Punëdhënës - person juridik dhe fizik ku nxënësit fitojnë kompetenca përmes trajnimeve praktike cilësore në procesin e punës.

Stazh pune - Aktivitet pune që përfshin një komponent pune nëpërmjet të nxënësit dhe përvetësimit të aftësive praktike të punës.

Tregu i punës - kornizë, ku oferta dhe kërkesa për punësim janë në ndërveprim dinamik me ofertën dhe kërkesën e fuqisë punëtore.

Mentor në biznes – punonjës profesionist që planifikon, organizon dhe realizon praktikën profesionale në kushte reale.

Mentorimi - një proces kompleks, ndërveprues që zhvillohet ndërmjet individëve me nivele të ndryshme të përvojës dhe ekspertizës.

Ditari/fletorja i/e praktikës profesionale - dokument i detyrueshëm për nxënësin në të cilin ai përshkruan aktivitetet ditore dhe përmbajtjen e tyre gjatë realizimit të praktikës profesionale.

Mësimi praktik - formë e organizuar shkollore e praktikës profesionale

Trajnimi praktik - Një grup aktiviteteve praktike për përvetësimin e kompetencave.

Trajnimi praktik në biznes - pjesë e trajnimit praktik të nxënësit që realizohet në një biznes.

Trajnimi për punën - Trajnim për kryerjen e detyrave, procedurave, proceseve, operacioneve të caktuara etj.

Të Nxënësit nëpërmjet Punës (TNP) - mësimi që zhvillohet në një mjedis real pune.

Të Nxënësit nëpërmjet Punës për një punëdhënës/biznes - mësimi që zhvillohet tek një punëdhënës/biznes në një mjedis real pune.

6. Referencat

1. Група автори, УПАТСТВО ЗА УЧЕЊЕ ПРЕКУ РАБОТА, Проект „Образование за вработување во Северна Македонија (E4E@мк)“, Скопје, 2022;
2. Чедо Димовски, Ardijana Isahi Palloshi, Прирачник за соработка на училиштата со компаниите за имплементација на критериумите за квалитет, ОеАД Регионален проект „Училиштата се сретнуваат со компаниите“, Скопје, 2020;
3. Роза Арсовска, Ардијана Исахи Палоши, Ридван Зеќири, Поимник за стручно образование и обука, Проект „Образование за вработување во Северна Македонија (E4E@мк)“, Скопје, 2019;
4. Група автори, УПАТСТВО ЗА ФЕРИЈАЛНА ПРАКТИКА, Проект „Образование за вработување во Северна Македонија (E4E@мк)“, Скопје, 2019;
5. Дејан Ђериќ, *Индивидуализована настава у практичној настави*, Факултет техничких наука, Чачак, 2014.
6. Vladislav Popov, „Priručnik za nastavnike SPŠ za Vežbe iz organske poljoprivrede“, FAO regionalna kancelarija za Evropu i Centralnu Aziju, Beograd, 2014.
7. Bailey, T. R.; Hughes, K. L.; Thornton Moore, D. (2004). Working Knowledge: Work-Based Learning and Education Reform] Routledge Falmer.
8. Boud, D. and Solomon, N. (2001). 'Work-Based Learning: A New Higher Education?', Taylor & Francis Inc.
9. DEWBLAM (2003-2006). Developing European Work Based Learning Approaches and Methods. Accessed 20/12/2010.
10. Garcia, L. (2020). Work-based learning in agriculture: A guide for teachers. Agrarian Education Publications.
11. Guide to Work-Based Learning. Policy and Practice for Secondary Education. (2023). Nevada Department of Education.
12. Perez, A. (2019). Mentoring and hands-on learning on grape farms. Journal of Agriculture, 23(4), 56-78.
13. Salome Amukun et.al. (2019). The Teaching Agriculture Practically (TAP) Through Student Exposure Visits. VVOB education for development. www.vvob.org.
14. Tom Lemanski, Ruth Mewis and Tina Overton (2011). An Introduction to Work-Based Learning. A Physical Sciences Practice Guide. UK Physical Sciences Centre Department of Chemistry University of Hull.
15. University of Hull. (2009). Work Based Project Module. Accessed November 2010.
16. Williams, A. and Thurairajah, N. (2009). 'Work-based Learning: Working the Curriculum: Approval, Delivery & Assessment ', University of Salford.



Internet

1. <https://ucioniacadobrevolje.wordpress.com/>
2. <https://prosveta.gov.rs/wp-content/uploads/2020/02/Prirucnik-za-skole-sa-primerima-dobrih-praksi.pdf>
3. https://www.revitalist.eu/uploads/1/1/4/3/114388427/trainers_guide_online.pdf
4. https://www.edc.org/sites/default/files/uploads/Workbased_Learning_Data_Collection_Toolkit_EDC_2022.pdf
5. https://www2.wested.org/www-static/online_pubs/workbasedlearning.pdf
6. http://www.flexwbl.org/wp-content/uploads/2020/11/10.-Introduction-to-work_based_learning.pdf
7. https://www.nj.gov/education/cte/secondary/wbl/docs/WBL_Handbook.pdf
8. https://www.edc.org/sites/default/files/uploads/Workbased_Learning_Data_Collection_Toolkit_EDC_2022.pdf
9. http://www.flexwbl.org/wp-content/uploads/2020/11/10.-Introduction-to-work_based_learning.pdf

